

# Të jetosh në Piemonte

## Udhëzues i shërbimeve për qytetarët e huaj

REGIONE PIEMONTE

ASSESSORATO ALLE POLITICHE SOCIALI

# Të jetosh
# në Piemonte

Udhëzues i shërbimeve
për qytetarët e huaj



Publikuar nën kujdesin e:

**Francesca Prunotto**
**Carla Martoglio**

Për redaktimin e teksteve kanë bashkëpunuar:

**Annamaria Avonto** - ASL 21 di Casale Monferrato
**Daniela Baradel** - INPS
**Angelo Calà** - Drejtoria Arsimore Fontana
**Flavio Campagna** - ASGI: Shoqata e Studimeve Juridike mbi Imigracionin
**Maria Elena Coffano** - Drejtoria e Shëndetësisë së Rajonit Piemonte
**Mariella Console** - ASGI: Shoqata e Studimeve Juridike mbi Imigracionin
**Alessia Crotta** - Observatori Rajonal mbi Imigrimin në Piemonte (IRES)
**Marta Guerra** - Zyra për të Huajt e Komunës së Torinos
**Massimo Pastore** - ASGI: Shoqata e Studimeve Juridike mbi Imigracionin
**Caterina Pomo** - UTG: Zyra Territoriale e Qeverisë për Torinon
**Manuela Spadaro** - ASGI: Shoqata e Studimeve Juridike mbi Imigracionin
**Antonella Sterchele** - Drejtoria e Punës dhe Pregatitjes Profesionale e Provincës së Torinos.

Sekretaria:

**Manuela Dotto**
**Maria Musacchio**

Progekti grafik

**Carlo Gaffoglio Design**

Shtypi

**Ages Arti Grafiche**

**Përkthimet u kryen nga Qendra Gjuhësore e Fakulteteve Humanistike** (CLIFU) e Universitetit të Torinos. Koordinimi: **prof. Marie-Berthe Vittoz**.

**Kolici Sabina** (Shqip); **Hamdi Rachida** (Arabisht); **Pecorale Roberto**, **NI Tianxiu** (Gjuhë Kineze); **Rigat Françoise, Anne-Catherine Caron** (Frëngjisht); **Spencer Alice, Ouroussoff Tatiana** (Anglisht); **Ileana Bunget, Vorotic Roxana, Ghiurca Clara** (Rumanisht); **Bolchakova Eugenia** (Rusisht); **Bermejo Calleja Felisa, Villen Peñalver Francisca** (Spanjisht).

Falenderohen:

**Giorgio Albertino** - EPACA: Patronati Coldiretti për shërbimet ndaj personit
**Enrico Allasino** - Observatori Rajonal mbi Imigrimin në Piemonte (IRES)
**Massimo Bocci** - EPACA: Patronati Coldiretti për shërbimet ndaj personit
**Antonietta Ragone** - INPS
**Mario Carzana** - Drejtoria e Shëndetësisë së Rajonit Piemonte
**Rosanna Lavezzaro** - Kuestura e Torinos
**Giovanna Vilasi** - Zyra Territoriale e Qeverisë për Torinon
**Giovanna Zincone** - Universiteti i Torinos
**CIDISS**: Qendra e Informacionit dhe Dokumentimit për Inserimin Shkollor të të Huajve

Një falenderim të vecantë Provincave Piemonteze
që kanë pregatitur listën e adresave dhe janë kujdesur për shpërndjarjen e udhëzuesit.

Drejtoria Rajonale e Politikave Sociale
Drejtor **Attilio Miglio**
Sektori i Programimit dhe Promovimit të Aksioneve Socio-Asistenciale

© Tutti i diritti riservati, riproduzione vietata.

Udhëzuesi i shërbimeve ndaj të huajve **"Të jetosh në Piemonte"** është realizuar nga Këshilli i Politikave Sociale, në kuadër të një Programi Marrëveshjeje që ky i fundit ka nënshkruar me Ministrinë e Punës dhe të Politikave Sociale, për aktivizimin dhe realizimin e projekteve që kanë për qëllim identifikimin e një modeli praktikash pozitive për integrimin social të imigrantëve jo komunitarë.

Udhëzuesi është i disponueshëm në nëntë gjuhë: arabisht, frëngjisht, gjuhë kineze, spanjisht, rumanisht, rusisht, shqip.

Në fund të udhëzuesit do të gjeni një fletëpalosje me adresat e Enteve të Shërbimit për cdo Provincë.

Versioni on-line i udhëzuesit gjendet në adresën internet të Observatorit Rajonal mbi Imigracionin në Piemonte: **www.piemonteimmigrazione.it**

Italia, historikisht vend emigracioni, në këto dhjetë vjecarët e fundit është shndërruar në një vend imigrimi.

Sot fenomeni karakterizon strukturalisht shoqërinë tonë, që po bëhet gjithnjë e më shumë multietnike e multikulturale.

Në këtë skenar është e nevojshme dhe e rëndësishme që institucionet të përballen më problematikat e integrimit për të ndërtuar, jo vetëm forma bashkëjetese paqësore por mbi të gjitha një shoqëri harmonike që ofron një mundësi zhvillimi e realizimi për të gjithë.

Udhëzuesi **"Të jetosh në Piemonte"** vjen tek ju si një instrument informacioni dhe ndihmese për arritjen e shërbimeve ndaj shtetasve të huaj me banim në rajonin tonë.

Përbëhet nga një seri kapitujsh që fokusojnë dhe ilustrojnë aspektet kryesore të jetës në Itali dhe tregojnë procedurat fondamentale që lidhen me to.

Hyrja dhe qëndrimi në Itali i emigrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë tonë, kalojnë detyrimisht edhe përmes informimit, dhe në këtë drejtim, është e rëndësishme që të gjithë të huajt të mund të gjejnë lehtësisht informacionet mbi rregullat kryesore të sistemit tonë.

Për këtë arsye, udhëzuesi është përkthyer dhe publikuar në 8 gjuhë të tjera përvec italishtes: arabisht, shqip, kinezisht, frëngjisht, anglisht, rumanisht, rusisht dhe spanjisht.

Qëllimi është që "Të jetosh në Piemonte: udhëzues për shërbimet ndaj të huajve" jo vetëm të pëlqehet nga publiku, por mbi të gjitha, të jetë një instrument i nevojshëm dhe efikas për të gjithë.

**Mariangela Cotto**

*Përgjegjës për Politakat Sociale*
*Për Rajonin Piemonte Piemonte*

**Enzo Ghigo**

*President i Rajonit Piemonte*





indice


**1 Hyrja dhe Qëndrimi** **13**
1.1 Si mund të hyet në Itali? 14
1.2 Si mund të qëndrosh në Itali? 16
1.3 Cfarë karakteristikash duhet të kenë masat me të cilat refuzohet kërkesa për hyrje, qëndrim apo masat për largimin e të huajit? 20
1.4 Si mund të apelohet kundër refuzimit të kërkesës për hyrje, qëndrim apo masës së largimit të të huajit? 21
1.5 Si paraqitet apeli ndaj mosdhënies së vizës së hyrjes? 25
1.6 Si paraqitet apeli ndaj masave në lidhje me lëshimin, renovimin apo refuzimin e lejes së qëndrimit ose kartës së qëndrimit? 26
1.7 Si paraqitet apeli ndaj masës së largimit në kufi? 27
1.8 Si paraqitet padia kunder dekretit te Ministrise se Brendshme per perjashtimin e te huajit? 27

**2 Dokumentat:** **karta e identitetit, kodi fiskal, çertifikata e rezidencës, patenta e qarkullimit.** **29**
2.1 Cfarë është karta e identitetit? 30
2.2 Cfarë është kodi fiskal? 32
2.3 Cfarë është "rezidenca"? 32
2.4 Për cfarë shërben patenta e guidës? 34
2.5 Cfarë është autocertifikimi? 36

**3 Shërbimet shoqërore** **39**
3.1 Kush siguron në Piemonte asistencën shoqërore dhe shëndetësore? 40

**4 Shëndeti dhe asisenca mjekësore** **43**
4.1 Cfarë është Shërbimi Shëndetësor Kombëtar? 44
4.2 Kush ka të drejtë për mjekun e familjes dhe pediatrit? 46
4.3 Cfarë shërbimesh garantohen? 47
4.4 Ku duhet të drejtoheni për kurat specifike dhe analizat laboratorike (të gjakut, radiologjike etj.)? 47
4.5 Kujt duhet t'i drejtoheni në rast "Urgjence"? 48
4.6 Ku blihen medikamentet? 48
4.7 Cfarë janë Konsultoret Familiare dhe Pediatrike? 49
4.8 A është e ligjshme në Itali ndërprerja e vullnetëshme e shtatzanisë? 51
4.9 A është e mundur në Itali mosnjohja e fëmijës në lindjen e tij? 51
4.10 Ku duhet të drejtoheni për asistencën mjekësore për fëmijët? 52
4.11 Cfarë vaksinash janë të deyrueshme dhe fakultative në Itali dhe profilaksitë? 53
4.12 A kanë të drejtë të huajt për asistëncën shëndetësore? 53

## indice


**5 Punësimi dhe Sigurimet Shoqërore** **59**
5.1 Ku duhet të drejtoheni kur kërkoni punë? 60
5.2 Cfarë mbulojnë kontributet shoqërore dhe përse është e rëndësishme të derdhen? 61
5.3 Cfarë ndodh në rast se punonjësi sëmuret? 63
5.4 Cilët janë shërbimet në mbrojtje të shtatëzanisë? 64
5.5 Cfraë është kompensimi për shtatëzaninë? 64
5.6 Cfarë është largimi (leja) e detyrueshme nga puna për shkak shtatëzanie? 65
5.7 Cfarë është leja (largimi) fakultative e barrës? 66
5.8 Cfarë janë pushimet ditore orare për të asistuar fëmijët? 67
5.9 A lejohet largimi nga puna në rast sëmundje të fëmijës? 68
5.10 Cfarë është ceku i shtatëzanisë? 68
5.11 Cfarë është ceku i shtatëzanisë dhënë nga Komuna? 69
5.12 Cilët janë shërbimet kryesore në mbrojtje të pleqërisë? 69
5.13 Cilat janë shërbimet previdenciale në rast invaliditeti fizik ose mendor të punonjësit? 72
5.14 Cfarë shërbimesh parashikohen për punonjësin që pushohet nga puna e që gjendet kështu i papunë? 73
5.15 Cfarë është kompensimi i zakonshëm për papunësinë? 73
5.16 Cfarë është kompensimi i zakonshëm i papunësisë me kërkesa të kufizuara? 75
5.17 Cfarë është kompensimi i zakonshëm për papunësinë për punëtorët e bujqësisë? 75
5.18 Cfarë janë trajtimet e vecanta për papunësinë për punëtorët e bujqësisë? 76
5.19 Cfarë është trajtimi i vecantë për papunësinë për punëtorët e ndërtimit? 78
5.20 Cilët janë shërbimet në mbrojtje të familjes? 78
5.21 Cfarë është ceku për bërthamën familjare? 78
5.22 Cfarë është ceku familjar? 79
5.23 A është i detyruar punëdhënësi të mbrojë shëndetin e punonjësit? 80

**6 Familja** **85**
6.1 Kush mund të kërkojë bashkimin familjar? 86
6.2 Si paraqitet cështja kundër mohimit së nulla osta apo të vizës së hyrjes për bashkim familje? 89
6.3 Si paraqitet cështja kundër masave të marra në lidhje me qëndrimin për motive familjare (lëshim, renovim dhe




indice


refuzim të lejes së qëndrimit për motive familjare)? 90
6.4 Cfarë kërkesash duhen përmbushur për t'u martuar në Itali? 90
6.5 Ku duhet të lajmërohet për lindjen e një fëmije? 92

**7 Të miturit e pashoqëruar** **95**
7.1 Cilët janë të miturit e huaj të pashoqëruar? 96

**8 Shkolla** **101**
8.1 Ku mund të dërgohen fëmijët e moshës nga 0 në 3 vjec? 102
8.2 Në cilën shkollë mund të dërgohen fëmijët e moshës nga 3 në 5 vjec? 102
8.3 Në cilën shkollë mund të dërgohen fëmijët e moshës nga 6 në 10 vjec? 103
8.4 Në cilën shkollë mund të dërgohen fëmijët e moshës nga 11 në 13 vjec? 104
8.5 Në cilën shkollë mund të dërgohen fëmijët e moshës nga 14 e më tej? 105
8.6 A ekzistojnë kontribute ekonomike për të lehtësuar shkollimin? 105
8.7 Cfarë është Detyrimi Shkollor? 107
8.8 A munden të rriturit të frekuentojnë shkollën? 108
8.9 Prej nga mund të merren informacione për regjistrimin në universitet? 109

**9 Nënshtetësia italiane** **111**
9.1 Kush merr automatikisht nënshtetësinë italiane? 112
9.2 Si paraqitet kërkesa për njohjen e statusit të qytetarisë italiane prej lindjes? 113
9.3 Kush merr nënshtetësinë italiane prej martesës? 114
9.4 Kush mer nënshtetësinë italiane prej natyralizimit? 114
9.5 Si paraqitet apelimi ndaj refuzmit të kërkesës për natyralizim? 115

**10 Refugjatët**
10.1 Si merret statusi refugjatit? **117**
10.2 Si paraqitet apelimi ndaj refuzimit të kërkesës për njohjen 118
e statusit të refugjatit? 122
10.3 Si paraqitet ankesa ndaj refuzimit të kërkesës për njohjen e strehimit politik, ose "kostitucional"? 123

**11 Tutela juridiksionale** **125**
11.1 Si është e garantuar asistenca ligjore(e një avokati) për qytetarin në kushte të vështira ekonomike? 126
11.1 Cfarë nënkuptohet me "barazi trajtimi"? 130
11.1 Si tutelohet në nivel juridiksional principi i barazisë në trajtim? 133




## Siglat kryesore që duhen njohur:

| | |
|---|---|
| **A.C.I.** | Automobile Club d'Italia |
| **A.S.L.** | Kompania Shëndetësore Lokale |
| **C.T.P.** | Qëndrat Territoriale Permanente |
| **INAIL** | Instituti Kombëtar i Sigurimeve për Aksidentet në Punë |
| **INPDAP** | Instituti Kombëtar i Previdencës për Nëpunësit e Administratës Publike |
| **INPS** | Instituti Kombëtar i Previdencës Sociale |
| **I.S.E.** | Indikator i Gjendjes Ekonomike |
| **I.S.I.** | Qendra e Informimit Shëndetësor |
| **MIUR** | Ministria e Arsimit, Universitetit e Kërkimeve |
| **p.d.s.** | Leje qëndrimi |
| **P.M.** | Pubblico Ministero |
| **S.T.P.** | I huaj përkohësisht i pranishëm |
| **T.A.R.** | Gjykata Administrative Rajonale |
| **T.C.M.** | Gjykata e Shkallës së Ulët me Përbërje Monokratike |
| **U.R.P.** | Zyrat e Maredhënieve me Publikun |
| **U.T.G.** | Zyra Territoriale e Qeverisë |



# 1 hyrja dhe qendrimi



*Per te hyre ne Itali e per te qendruar ligjerisht, qytetaret e Vendeve qe nuk bejne pjese ne Bashkimin Europian duhet te marrin nga autoritetet italiane autorizimin perkates (vize hyrje, leje qendrimi, etj.)*

## 1.1 Si hyhet ne Itali?

*Hyrja ne Itali, pervec rasteve te forces madhore, mund te kryhet vetem nepermjet pikave te kalimit kufitar te krijuara posacerisht, ku i huaji – nese i kerkohet – duhet te tregoje se ploteson kushtet e pergjithshme te nevojshme dhe vizen e hyrjes.*

### Cilat jane kushtet e nevojshme?

- Qellimi dhe kushtet e qendrimit;
- Mundesia e mjaftueshme e mjeteve te mbeshtetjes per te gjithe kohezgjatjen e qendrimit, duke bere perjashtimin e lejeve te qendrimit per motive pune, edhe per kthimin ne vendnisje.



### Cfare eshte viza e hyrjes?

Viza e hyrjes eshte dokumenti qe i kerkohet cdo te huaji jo komunitar[1] qe deshiron te hyje ne Itali per qendrim me kohezgjatje me shume se 90 dite.
Per qendrim me kohezgjatje me pak se 90 dite, viza nuk kerkohet gjithmone[2].
Ne kete rast jane te vlefshme edhe vizat e hyrjes te leshuara nga autoritetet diplomatike o konsullatat e shteteve te tjera.

Nese kerkesa eshte e justifikuar nga arsye te punesimit, viza leshohet vetem ne kuadrin e kuotave te hyrjes te caktuar ne dekretin vjetor te programimit te flukseve migruese.

Per te huajin me qendrim te rregullt ne Itali, per te hyre e per te dale nga territori kombetar, eshte e mjaftueshme qe te paraqese pashaporten dhe lejen e qendrimit e vlefshme.

Ndersa **leja e rihyrjes** eshte e nevojshme kur leja e qendimit eshte humbur ose e kane vjedhur, ose kur ka skaduar; ne keto raste, kerkeses te vizes i duhet bashkangjitur leja e qendrimit e skaduar prej jo me shume se 60 ditesh.





## Ku kerkohet viza?

Viza u duhet kerkuar autoriteteve diplomatike ose konsullore italiane te vendit te origjines ose te vendbanimit, duke i bashkangjitur:

- Pashaporten (ose dukumentin me vlere te njejte) e vlefshme;
- dokumentacionin perkates ne baze te tipit te vizes se kerkuar[3].

I huaji duhet te tregoje arsyet e udhetimit, vendin ku do te shkoje, mjetet e trasportit qe do te perdore e te vertetojë zoterimin e mjeteve te jeteses per kohezgjatjen e udhetimit.

1

[1] Bejne prejashtim qytetaret e San Marino, Qytetit te Vatikanit, Lihtenshteinit, Zvizera, Norvegjise, Islanda, me te cilat eshte ne fuqi marreveshja e qarkullimit te lire.

[2] Qytetaret qe vijne nga vendet e poshterenditur, te paisur me pashaporte normale, duhet te pajisen me visen e hyrjes: Afghanistan, Shqiperia, Algjeria, Angola, Antigua e Barbuda, Arabia Saudite, Armenia, Azerbaixhan, Bahamas, Bahrein, Bangladesh, Barbados, Belize, Benin, Bhutan, Bielorusia, Bosnia-Hercegovina, Botswana, Burkina Faso, Burundi, Kamboxhia, Kamerun, Kapo Verde, Africa qendrore, Ciad, Kina, Kolombia, Komore, Kongo, Kongo (Republika Demokratike), korea e veriut, Bregu i fildisht, Kuba, Dominika, Republika domenikane, Egjipt, Emiratet e bashkuara arabe, Eritrea, Etiopia, ish-Republika jugosllave e Maqedonise, Fixhi, Filipine, Gabon, Gambia, Gjeorgjia, Ghana, Xhiamaika, Gibuti, Jordania, Grenada, Guinea, Guinea Bissau, Guinea Ekuatoriale, Guyana, Haiti, India, Indonezia, Iran, Irak, Kazakistan, Kenia, Kirghizistan, Kiribati, Kuwait, Laos, Lesotho, Liban, Liberia, Libia, Madagaskar, Malawi, Maldive, Mali, Mariane e veriut, Marok, Marshall, Mauritania, Mauritius, Micronesia, Moldova, Mongolia, Mozambico, Namibia, Nauru, Nepal, Niger, Nigeri, Oman, Pakistan, Palau, Papua-Nuova Guinea, Perù, Qatar, Republika Federale e Jugosllavise (Serbia e Mali i zi), Ruanda, Rusia, Saint Kitts e Nevis, Saint Lucia, Saint Vincent e Grenadine, Salomone, Samoa Occidentali, Sao Tomé e Principe, Senegal, Seychelles, Sierra Leone, Siria, Somalia, Sri Lanka, Africa e jugut, Sudan, Suriname, Swaziland, Taxhikistan, Taiuan (entitet territorial i pa njohur), Tanzania, Thailand, Togo, Tonga, Trinidad e Tobago, Tunizi, Turkia, Turkmenistan, Tuvalu, Ucraina, Uganda, Uzbekistan, Vanuatu, Vietnam, Yemen, Zambia, Zimbabwe.

Qytetaret e vendeve te poshterenditur jane te perjashtuar nga **kushti i vizes se hyrjes per qendrim jo me shume se 90 dite, per turizem, mision, biznes, ftese e gara sportive:**
Andorra, Argjentina, Australia, Bolivia, Brasil, Brunei, Bulgaria, Kanada, Kili, Qipro, Korea e jugut, Kosta Rika, Kroazia, Ekuador, El Salvador, Estonia, Japoni, Guatemala, Honduras, Israel, Letonia, Lituania, Malezia, Malta, Meksik, Monako, Nikaragua, Zelanda e re, Panama, Paraguay, Poloni, Republica Ceke, Rumani, Singapore, Slovaki, Slovenia, Shtetet e bashkuara te amerikes, Hungari, Uruguay, Venezuela.

[3] Tipe te vizes:
Per biresim, biznes, kurim mjekesor, motive diplomatike, bashkim familjar, gara sportive, ftese, pune te pavarur, punesim, mission, motive fetare, rihyrje, vendeqendrim i zgjedhur, studim, kalim transitor me avion, kalim tranzit, transport, turizem, pushime-pune.

## 1.2 Si qendrohet ne Itali?

***Leja e qendrimit*** *eshte dokumenti qe autorizon te huajt qe hyjne rregullisht ne Itali te qendrojne ne territorin kombetar[4].*

### Ku kerkohet leja e qendrimit?

Leja e qendrimit i duhet kerkuar Kuestorit te vendit te destinimit[5] brenda **8 diteve** pune nga data e hyrjes duke i bashkangjitur dokumentet qe vijojne:

- fotokopja e pjeses se brenshme te pashaportes dhe paraqitja e vete pashaportes (pasi ta kete pare, policia ia kthen te zotit);
- viza e hyrjes;
- tre fotografi me format tesre;
- nje pulle takse me vlere prej 10.33 Euro;
- nje vertetim e vendbanimit.

Kuestura mban nje kopje te kerkeses me te gjithe dokumentacionin ndersa kopja tjeter i dorezohet te huajit si deftese e kerkeses.

I huaji qe kerkon lejen e qendrimit i nenshtrohet marrjes se shenjave te gishterinjve.

### Per sa kohe eshte e vlefshme leja e qendrimit?



Kohezgjatja e lejes se qendrimit eshte ajo qe parashikohet nga viza e hyrjes dhe varet nga arsyeja per te cilen eshte leshuar viza.

Sidoqofte nuk mund te jete me teper se:

- **3 muaj** per vizita, biznes e turizem;
- **9 muaj** per pune sezonale (i huaji qe verteton ardhjen ne Itali per te pakten dy vjet rradhazi per te bere pune stinore, mund t'i leshohet nje leje shumevjecare – deri ne 3 vjet – per te njejten kohezgjatje vjetore qe ka perfituar ne vitin e fundit te 2 viteve paraardhes);
- **1 vit** per pune te varur me kohe te caktuar;
- **2 vjet** per pune te varur me kohe te pacaktuar, pune te pavarur, bashkim familjar;
- **1 vit** per studim ose kurse informative

Leja e qendimit per arsye pune ka te njejten kohezgjatje si kontrata e qendrimit[6].

**Hymbja e vendit te punes (edhe per pushim nga puna) nuk shkakton per punetorin jo komunitar dhe per familjaret e tij qe qendrojne ligjirisht humbjen edhe te lejes se qendrimit.**



Kjo e fundit vazhdon t'i lejoje te qendroje ligjerisht ne territorin e Shtetit italian per periudhen e mbetur te vlefshmerise, e sidoqofte per te pakten 6 muaj (me perjashtim te rasteve kur behet fjale per pune stinore).
Ne kete interval kohe i huaji ka mundesine te kerkoje nje vend te ri pune.

## Si riperteritet leja e qendrimit?

Riperteritja i kerkohet ne dy kopje Kuestorit[7] te provinces se qendrimit, duke i bashkangjitur dokumentat ne vijim:

- Lejen e qendrimit te skaduar dhe pashaporten;
- tre fotografi me format tesere;
- nje pulle takse me vlere prej 10.33 Euro;
- nje vertetim te vendbanimit;
- nje vertetim qe tregon ekzistencen e mjeteve te jeteses;
- nje vertetim qe tregon mjaftueshmerine e ketyre mjeteve per kohezgjatjen e qendimit dhe per kthimin ne atdhe;
- dokumentat e nevojshme ne lidhje me lejen e qendimit specifike (per turizem, per pune, per bashkim familjar etj.).

Riperteritja e perzgjatja nuk lejohen per arsye turismi dhe ne raste te qendrimit jashte Italise per kohe te gjate e te vazhdueshme (per me shume se 6 muaj, dhe ne rastin e lejes se qendimit dyvjetore, per me shume se 1 vit).
Ne kundershtim me sa me siper lejohet riperteritja ne rastin kur i huaji largohet nga Italia per te permbushur detyrimet ushtarake ose per arsye te tjera te renda te vertetuara.





4 Tipe te lejes se qendrimit:
per turizem, vizite tek familiaret, biznes, pune te perkohshme, studim ose kurse informative, pune te pavarur, punesim, motive familjare, mbrojte shoqerore, punonjes te spektaklit, kurim mjekesor, strehim politik, strehim humanitar.

5 shih paragrafin me shpjegime te vecanta.

6 **Kontrata e qendrimit per motive punesimi**, realizohet midis punedhenesit italian ose te huaj qe qendron rregullisht ne Itali, dhe punemarresit, qytetar jo i komunitetit, dhe nenshkrohet prane **Sportelit Unik per emigracionin** (shih deftuesin ne fund broshures) te krahines ku banon ose ka adresen juridike punedhenesi ose atje ku do te vendoset punemarresi.

7 shih paragrafin me shpjegime te vecanta.



### Kur kerkohet riperteritja?

Kerkesa duhet bere:

- 90 dite perpara skadimit te lejes se qendrimit, ne rastet e kontrates se punes se varur me kohe te papercaktuar;
- 60 dite perpara, ne rastet e punes se varuar me kohe te percaktuar;
- 30 dite ne rastet e tjera.

### Sa zgjat riperteritja?

Riperteritja, ne pergjithesi, ka nje kohezgjatje jo me te gjate se sa ajo e percaktuar ne lejen e leshuar fillimisht.

### Kur mund te konvertohet nje leje qendrimi?

- Leja e qendrimit per pune te pavarur mund te konvertohet ne leje qendrimi per pune te varur e anasjelltas;
- leja e qendimit per pune stinore mund te konvertohet ne leje qendrimi per pune te varur, por vetem ne fund te stines se dyte (shih me siper);
- Leja e qendrimit per studim mund te konvertohet ne leje qendrimi per pune, por brenda numrit te hyrjeve te parashikuar nga qeveria nga viti ne vit;
- Leja per arsye te mbrojtjes sociale mund te konvertohet ne leje per studim ose per pune, nese ne skadim te lejes i huaji po studion ose po punon.



### Kujt duhet t'i tregoje lejen e qendrimit qytetari i huaj?

Qytetari i huaj duhet t'i tregoje lejen e vet te qendrimit sa here qe i kerkohet nga oficeret e agjentet e sigurimit publik.

Forcat e Rendit, nese e konsiderojne te nevojshme, mund te kerkojne informacione te metejshme e dukumente te punes, banimit dhe te te ardhurave qe i huaji zoteron ne Itali per te mbajtur familjaret qe ka ne ngarkim.

### Cfare eshte karta e qendrimit?

**Karta e qendrimit** eshte dokumenti qe i lejon te huajve qendrimin ne Itali me kohe te papercaktuar.
Zoteruesi i kartes se qendrimit mund te perzihet vetem per arsye te renda te rendit publik ose te sigurise kombetare ose nese eshte shoqerisht i rrezikshem.



Duhet vulosur cdo 10 vjet dhe i lejon zoteruesit:
- te hyje e te dale nga Italia pa pasur nevoje per vize;
- te zhvilloje cdo aktivitet te ligjshem qe nuk eshte i rezervuar per qytetaret italiane;
- te gezoje sherbimet e administrates publike.

## Kush mund te kerkoje Karten e qendrimit?

Qytetari i huaj qe:
- qendron ligjerisht ne Itali per se paku 6 vjetesh dhe qe ka nje leje qendrimi qe lejon riperteritje;
- eshte martuar me nje te huaj qe ka karten e qendrimit;
- kam me pak se 18 vjec dhe eshte femija e nje te huaji qe ka karte qendrimi;
- bashkeshorti, i mituri dhe prinderit e qytetarit italian (pra, edhe te huajit qe ka perfituar nenshtetesine italiane) ose te qytetari komunitar banues ne Itali, me kusht qe të bashkejetojne.

## Ku paraqitet kerkesa per te perfituar Karten e Qendrimit?

Karta e Qendrimit i kerkohet drejtepersedrejti Kuestures[8].

I huaji duhet te tregoje ne kerkesen:
- te dhenat e veta te gjendjes civile;
- vendet ku ka jetuar ne pese vitet paraardhese te kerkeses;
- vendbanimin ne momentin e kerkeses;
- burimet e te ardhurave qe i lejojne te jetoje ne Itali.

Kerkeses i duhen bashkangjitur:
- kopja e nje dokumenti identiteti;
- kopja e deklarates se te ardhurave ose te deklarimit te fundit te te ardhurave qe rrjedhin nga aktiviteti i punes se varur
- certifikata e kartotekes gjykatore;
- certifikata qe verteton mungesen e ndjekjeve penale ne vijim;
- nje fotografi format tesere.

Pasi verteton ekzistencen e te gjitha parakushteve, kuestori leshon Karten e Qendrimit brenda 90 diteve nga paraqitja e kerkeses. Karta e qendrimit mund te

[8] shih paragrafin me shpjegime te vecanta.



terhiqet ne rastin e denimit per vepra penale vecanerisht te renda. Kush zoteron lejen e qendrimit dhe banon vazhdueshmerisht ne Itali mund te perfitoje rregjistrimin ne zyren e gjendjes civile dhe leshimin si rrjedhoje te **leternjoftimit** me kohezgjatje te njejte me lejen e qendrimit, si edhe leshimit e kodit fiskal[9].

## 1.3 Cfare karakteristikash duhet te kene masat e marra per te refuzuar kerkesen e hyrje, te qendrimit dhe ato me te cilat behet e mundur largimi (perjashtimi) i te huajit?

*Kur te huajit i mohohet autorizimi i hyrjes dhe i qendrimit, autoritetet perkatese marrin **masen e refuzimit**.*
*Nese te dhenat e lejojne, nga ana tjeter, kundrejte te huajit mund te praktikohet edhe **dekreti i largimit ose i kthimit ne kufi.***

Ne keto raste ekzistojne disa rregulla te pergjithshme qe autoritetet duhet te vezhgojne me kujdes:





- Te gjitha masat administrative ne lidhje me hyrjen , qendrimin ose largimin e te huajit, duhet te jene te shkruara e te motivuara.
  Te interesuarit duhet t'i jepet nje akt me shkrim, ku duhet te jene shpjeguar shkaqet dhe arsyet juridike qe cuan ne marrjen e masave te siperpermendura. Bejne perjashtim masat e marra per mohimin e vizes se hyrjes, per te cilen kushti i motivimit eshte parashikuar vetem punesim, bashkim familjar, studim e kurim mjekesor.
  Ne aktin juridik ne te cilin shpjegohet c'ka me siper, duhet gjithashtu te nenvizohet se cilit autoritet mund t'i drejtohet ne rast ankimi dhe brenda sa kohesh.
- Te gjitha masat e marra ne lidhje me hyrjen, qendrimin, ose perjashtimin e te huajit, duhet te **perkthehen ne nje gjuhe te kuptueshme nga ai te cilit i perket akti.** Nuk eshte e nevojshme nje perkthim total i aktit, pasi sipas ligjit, eshte i mjaftueshem edhe nje perkthim permbledhes.
  Ne rastin kur nuk mundesohet perkthimi ne nje gjuhe te njohur, akti duhet te perkthehet ne gjuhen francese, anglisht ose spanjisht (ose arabisht nese behet fjale per mohim te vizes se hyrjes), me shenimin per gjuhen e preferuar nga i interesuari.
- Te gjithe aktet administrative ne lidhje me hyrjen, qendrimin ose perjashtimin e te huajit, duhet te jene **te noterizuara drejtpersedrejti nga i interesuari**, te



cilit i kerkohet te firmose aktin e noterizimit.
Noterizimi eshte i vlefshem edhe nese i interesuari nuk pranon te firmose aktin. Ne cdo rast, te interesuarit i duhet dorezuar nje kopie e aktit, me perkthimin perkates te bashkangjitur, edhe pse i permbledhur, ne nje gjuhe te njohur, pra ose frengjisht, anglisht ose spanjisht.

## 1.4 Si mund te veprohet kunder masave te marra me te cilat mohohet kerkesa e hyrjes, e qendrimit dhe me te cilat behet i mundur largimi (perjashtimi) i te huajit?



Te huajit qe i eshte notifikuar:
- Masa e mohimit te kerkeses per vizen e hyrjes;
- Masa e mohimit te kerkeses per lejen e qendrimit;
- ose i eshte notifikuar akti i perjashtimit o refuzimit ne kufi;

i njihet e **drejta e tuteles juridike**, mundesia, per te bere padi prane nje organi juridik.
Ne pergjithesi padia eshte funksion i nje limiti kohor, qe duhet theksuar ne aktin e mohimit ne momentin e notifikimit te tij, dhe qe fillon qe nga dita qe akti firmoset nga i interesuari.
Koha e paraqitjes se padise eshte e percaktuar, kjo do te thote qe padia konsiderohet e pavlefshme nese paraqitet pas kohes se parashikuar.
Por, ne raste te vecanta (p.sh. kur ne akt nuk eshte percaktuar limiti kohor brenda te cilit duhet te paraqitet padia, ose ne rastin kur notifikimi i aktit eshte bere pa perkthimin e duhur) eshte e mundur te paraqitet padia edhe pse limiti kohor eshte tejkaluar, duke i kerkuar gjykatesit "falje sipas kushteve".
Ne disa raste paraqitja e padise nuk eshte e kufizuar ne kohe.
Per sa lejon disiplina e shpenzimeve gjygjsore, eshte parashikuar nje derdhje e nje sasie te unifikuar, te te gjitha padive prane Gjykates administrative te krahines e Gjykates me perberje kolegjiale.



[9] Per te ditur se cfare jane e sesi behet e mundur marrja e lejes se njoftimit shih kap. N.2.

Eshte ende e paqarte procedura e padise, prane gjykates, ndaj akteve te komisioneve te rretheve , mbi statusin e refugjateve, per te cilet, aktualisht, ligji nuk parashikon masa perjashtimi.

Menyrat sesi mund te behet padia kunder masave te marra per mohimin e perjashtimin, ndryshojne ne varesi te tipit te masave te shpjeguara ne aktin notaril.



[10] shih paragrafin me shpjegime te vecanta.





## LLOJET E PADIVE

- Padi ndaj mohimit te vizes se hyrjes.
- Padi kunder masave per leshimin, rinovimin o terheqjes se lejes se qendrimit ose kartes se qendrimit.
- Padi kunder mases se kthimit ne kufi.
- Padi kunder dekretit te perjashtimit te Ministrise se brendshme.
- Padi kunder mohimit te autorizimit e mohimit te vizes se hyrjes per bashkimin familjar[11].
- Padi kunder mohimit te qendrimit per probleme familiare (leshimin, rinovimin o terheqjes se lejes se qendrimit per motive familiare)[12].
- Padi kunder mohimit te kerkeses per naturalizimin (leshimit te qytetarise italiane per rezidente mbi dhjetevjecare o per mbi pesevjecare per ate te martuar me qytetare italiane dhe per raste te tjera te parashikuara nga ligji)[13].
- Padi per njohjen e statusit te qytetarise italiane nga lindja, ose te statusit te apolide.[14]
- Padi kunder mohimit te kerkeses per njohjen e statusit te refugjatit.[15]
- Padi per njohjen e statusit te refugjatit politik ose refugjat "sipas kushtetutes" ish art. 10 i Kushtetutes.[16]





## 1.5 Si paraqitet padia kunder mohimit te vizes se hyrjes?
(perjashtohen vizat per bashkim familiare)[17].

**Autoritet gjygjesor kompetent.**
Gjykata Administrative e Krahines (T.A.R.) se Lazio, me qender ne Rome[18].

**Kohezgjatje per paraqitjen e padise.**
60 dite nga noterizimi i aktit.

**Shpenzime per te drejten.**
Shpenzim i pergjithshem.
Kjo nuk varet nese i interesuari merret ne mbrojtje nga ana legale, me shpenzimet e bera nga shteti[19].

**Informacione te vecanta.**
Nese behet fjale per vize hyrje, i interesvari e merr aktin notaril te mohimit te kerkeses prane Konsullates italiane ne shtetin ku jeton.
Te njejtat autorite te konsullates jane te detyruar, nese kerkohet, te bejne autentifikimin e firmes ne fund te aktit dhe/ose te prokures se vecante dorezuar avokatit per te paraqitur padine. Kjo e fundit duhet te jete e noterizuar brenda 60 diteve prane Ministrise se jashtme, prane Avokatesise se shtetit me qender ne Rome.

**Per asitencen juridike te bere nga shteti (gratis mbrojtja)[20].**

1



11 - 12 shih kap.6: Familja.
13 - 14 shih kap.9: Qytetaria.
15 - 16 shih kap.10: Refugjatet.
17 shih kap.6: Familja.
18 shih paragrafin me shpjegime te vecanta.
19 - 20 shih kap. n. 11. Tutela juridike.

## **1.6 Si paraqitet padia kunder masave per sa i perket leshimit, rinovimit ose terheqjes se lejes se qendrimit ose te kartes se qendrimit?** perjashtohen vizat per bashkim familiare[21].

**Autoritet gjygjesor kompetent**.
Gjykata Administrative e Krahines (T.A.R.) ne te cilen ka qendren administrative kuestura qe ka leshuar marrjen e mases[22].

**Kohezgjatje per paraqitjen e padise**.
60 dite nga noterizimi i aktit.

**Shpenzime per te drejten**.
Shpenzim i pergjithshem.
Kjo nuk varet nese i interesuari merret ne mbrojtje nga ana legale, me shpenzimet e bera nga shteti[23].

**Informacione te vecanta**.
Ne momentin e noterizimit te aktit te marrjes se mases me anen e te cilit mohohet kerkesa e leshimit ose rinovimit te lejes se qendrimit, ose te aktit me anen e te cilit kerkohet mohimi i terheqjes, te huajit i kerkohet qe brenda 15 diteve te largohet nga territori kombetare, edhe pse kohezgjatja per te paraqitur padine eshte 60 dite.Pasi kane kaluar 15 dite dhe i huaji gjendet ende ne territorin kombetar, behet e mundur leshimi i nje dekreti per perjashtimin e tij, qe noterizohet edhe pse nder kohe i huaji ka paraqitur padine prane T.A.R.
Por T.A.R. mund te ndaloj egzekutimin e mases se mohimit .
Ne kete rast, i huaji mund te perjashtohet per qendrimin e tij mbi 15 dite.

21 shih kap.6: Familja.
22 shih paragrafin me shpjegime te vecanta.
23 shih kap. n. 11. Tutela juridike.
24 shih paragrafin me shpjegime te vecanta.
25 - 26 shih kap. n. 11. Tutela juridike.
27 shih paragrafin me shpjegime te vecanta.
28 - 29 shih kap. n. 11. Tutela juridike.

## 1.7 Si paraqitet padia kunder mases se kthimit ne kufi (perjashtim)?

**Autoritet gjygjesor kompetent.**
Gjykata Administrative e Krahines (T.A.R.)ne vendin ku ka zyrat policia e kufirit o questura qe ka marre masen[24].

**Kohezgjatje per paraqitjen e padise.**
60 dite nga noterizimi i aktit.

**Shpenzime per te drejten.**
Shpenzim i pergjithshem. Kjo nuk varet nese i interesuari merret ne mbrojtje nga ana legale, me shpenzimet e bera nga shteti[25].

**Per asitencen juridike te bere nga shteti (gratis mbrojtja)[26].**

1

## 1.8 Si paraqitet padia kunder dekretit te Ministrise se Brendshme per perjashtimit e te huajit?



**Autoritet gjygjesor kompetent.**
Gjykata Administrative e Krahines (T.A.R.) se Lazio, me qender ne Rome[27].

**Kohezgjatje per paraqitjen e padise.**
60 dite nga noterizimi i aktit.

**Shpenzime per te drejten.**
Shpenzim i pergjithshem. Kjo nuk varet nese i interesuari merret ne mbrojtje nga ana legale, me shpenzimet e bera nga shteti[28].

**Informacione te vecanta.**
Behet fjale per raste te vecanta dhe te rralla, eshte rasti i perjashtimit te menjehershem sipas nje urdherese te Ministrise se Brendshme, per motive te rregullit publik ose te sigurise se shtetit.

**Per asitencen juridike te bere nga shteti (gratis mbrojtja)[29].**


REPUBBLICA ITALIANA
MINISTERO DELLE FINANZE
CARTA




# 2 dokumentat

leter njoftimi
numri i regjistrimit
çertifikate banimi
patente per drejtimin e mjeteve te udhetimit

## 2.1 Cfare eshte rezidenca?

*Rezidenca eshte vendi ku nje person jeton zakonisht[1].*

*Qytetari jo i komunitetit, ne moshe madhore, i pajisur me leje qendrimi me nje kohezgjatje me shume se 3 muaj, ka te drejte te regjistrohet prane zyres se gjendjes civile te komunes ku jeton.[2]*

### Ku dhe si pregatitet kerkesa per regjistrimin e rezidences?

Kerkesa per regjistrimin e rezidences duhet te paraqitet duke dorezuar prane zyres se gjendjes civile[3] te komunes ku mendon te banoje, bashkangjitur dokumentat e meposhtem:

- Pashaporte te vlefshme
- Lejen e qendrimit ose karten e qendrimit te vlefshme (pra jo te skaduar)
- Kodin e regjistrimit
- Kontraten e banimit te regjistruar
- Deklarate te siperfaqes se shkelur te rezidences (qe behet ne rastin kur eshte hera e pare qe behet kerkesa), ose fletepagesen e takses se mbeturinave.

Zyra e gjendjes civile i leshon kerkuesit nje deftese ku deshmohet rezidenca, dhe ne vijim, ben nje verifikim, permes policise bashkiake, te deklarimit te rezidences.

### Cfare behet ne rastin e rinovimit te lejes se qendrimit o te kartes se qendrimit?

Brenda 60 diteve pas renovimit te lejes se qendrimit ose te kartes se qendrimit, i huaji i regjistruar ne zyren civile, ka detyrimin te rinovojne deklaraten e rezidences duke i bashkengjitur kesaj te fundit kopjen e lejes se re te qendrimit, me nje komunikim direkt bere zyres se gjendjes civile.

Ne rast se ky komunikim nuk behet, i huaji fshihet nga listat e popullsise qe banon ne Komune.

### Per çfare sherben regjistrimi i rezidences?

Regjistrimi i popullates ne zyren e gjendjes civile te nje komune, eshte i domosdoshem per:

- leshimin e leter-njoftimit;
- te paraqitur kerkesen per banim ne ndertesat e banimit publik;
- te mundesuar ndihmen e sherbimit shoqeror[4].



### Kush jeton ne nje komunitet a mund te kerkoje regjistrimin civil te rezidences?

Eshte e mundur te kerkohet regjistrimi i rezidences edhe pse jetohet ne nje komunitet (p.sh.: qender mikpritje, kolegj, etj.)
Ne kete rast kerkesa duhet te nenshkruhet nga pergjegjesi i ambjentit ku jetohet (p.sh.: nga pergjegjesi i shtepise se mikpritjes).

### Kush e ben deklaraten per rezidencen e familjes?

Kerkesa e regjistrimit te rezidences te nje familje, mund te behet nga cdokush prej pjestareve, mjafton qe ky i fundit te jete ne moshe madhore.

Nese banohet prane nje familje tjeter eshte e nevojshme leja e kryetarit te familjes.

Gjendja familiare, (gjendja civile e nje familje) eshte e perbere nga te gjithe personat qe jetojne ne te njejtin vendbanim.
Megjithate, nese nuk egzistojne rrethana familiare, te marteses, fiserise, adoptimi, tutela, mund te kerkohet regjistrimi ne nje gjendje te ndryshme civile te familjes.

2



*Per informacione me te hollesishme eshte e mundur te kontaktohet*

**Numrin jeshil 800 19585**

[1] Vendqendrimi eshte vendi ku nje person ka vendosur zyren kryesore te punes e interesave te tij.

[2] Qytetaret e huaj, qe rrjedhin nga qytetare te lindur italiane, te pajisur me leje qendrimi te vleshme, mund te kerkojne regjistrimin ne zyren e gjendjes civile, regjistrim ky i nevojshem per te nisur praktikat e proçesit te marrjes se qytetarise italiane, pavaresisht nga motivi dhe kohezgjatja e lejes se qendrimit.

[3] Shih adresat ne fund te udhezuesit.

[4] Per te ditur me shume mbi ndihmat e sherbimeve shoqerore shih kap.n.3. te Sherbimit Shoqeror.

## 2.2 Cfare eshte leter-njoftimi?

*Eshte nje dokument i njohjes personale qe mund te kerkohet nga cdo qytetar i huaj, qe ka karakteristikat e poshterenditura:*

- ka nje leje qendrimi te rregullt e konform ligjit
- ka regjistrimin ne nje gjendje civile ne territorit italian;
- ka me shume se 15 vjet jete.

Leter-njoftimi, ne rastin e te huajve dhe apolideve, por qe qendrojne ligjerisht ne territorin italian, ka te njejten kohezgjatje te lejes se qendrimit dhe nuk eshte e vlefshme per udhetime jashte shtetit, pasi ka vlere vetem ne territorin italian.

Per te bere te mundur pasjen e leter-njoftimit eshte e nevojshme paraqitja prane **zyres se gjendjes civile te komunes ose rrethit ku eshte vendbanimi**[5] duke paraqitur:

- 3 fotografi te reja format pashaporte,
- nje dokument te vlefshem njohjeje per qytetaret e Komunitetit Europian;
- pashaporte te vlefshme (qe nuk ka skaduar) dhe lejen e qendrimit ne rastin e qytetarit jo komunitar.

Ne rastin e humbjes se leter-njoftimit eshte e detyrushme te behet denoncimi prane autoriteteve te policise, e me pas te paraqitet nje kopje e aktit te denoncimit ne zyren e gjendjes civile ku do te behet kerkesa per leshimin e nje leter-njoftimi te ri, bashkangjitur me kerkesen duhet te paraqiten 3 foto, nje dokument i vlefshem, dhe leja e qendrimit.



## 2.3 Cfare eshte kodi i regjistrimi (fiskal)?

*Eshte nje kod i perbere nga shkronja e numra me anen e te cilit Ministria e Financave ben njohjen e personit. Cdonjeri ka kodin e tij personal.*

Menjehere pasi merret leja e qendrimit, duhet paraqitur prane zyres lokale te agjensise se Ministrise se Finances, dhe behet kerkesa per pajisjen me kodin e regjistrimi personal.

Adresat e zyrave te ndryshme te shperndara ne territorin krahinor mund te gjenden duke pare ne adresen internet:
**www.agenziaentrate.it/indirizzi/agenzia/uffici_locali/lista.htm?m=1&r=Piemonte**

Per t'u pajisur me kodin e rregjistrimit personal, duhet te paraqiten:

- Leja e qendrimit e vlefshme;
- Fotokopja e pashaportes se perdorshme.



Kush ka nje kod te regjistrimit personal mund:

- Te regjistrohet ne regjistrat e sherbimit shendetesor
- Ben te mundur punesimin
- Mund te nise nje aktivitet te pavarur;
- Ben te mundur realizimin e cfaredo lloj kontrate (p.sh. banimi, punesimi, shitje);
- Mund te hape nje llogari rrjedhese ne banke.

Nese tesera humbet ose vidhet, mund te kerkohet nje kopje prane zyres lokale te siperpermendur ose edhe prane sportelit te vetsherbimit, te pranishem ne zyrat e marredhenieve me publikun ne komunat e prefekturat, prane zyrave te finances e ne disa zyra te sherbimit postar, qendra tregtare e aereoporte.

Kopja mund te kerkohet edhe nepermjet internetit ne adresen:
**www.agenziaentrate.it/servizi/duplicatocf**



*Per informacione te metejshme mund te konsultoni adresen ne internet:*

**www.agenziaentrate.it/servizi**



[5] Shih adresat ne fund te udhezuesit.





## 2.4 Per cfare sherben leja e qarkullimit?

*Leja e qarkullimit eshte nje dokument qe mundeson drejtimin e nje mjeti te qarkullimit konform kategorise per te cilen leja eshte leshuar.*

Kerkesa per leshimin ose rinovimin e lejes se qarkullimit, duhet paraqitur prane **Zyres se qarkullimit rrugor (MCTC)**[6] ne zonen e rezidences.

### A eshte e mundur ne Itali te drejtohet nje mjet qarkullimi duke pasur nje leje qarkullimi te huaj?



Pergjate vitit te pare te qendrimit, ose per sa kohe nuk paraqitet kerkesa e vendqendrimit ne Itali, qytetaret jokomunitare[7] qe duan te drejtojne nje mjet qarkullimi ne Itali, duhet te jene te pajisur:

- me lejen e qarkullimit qe zoterojne
- me lejen e qarkullimit nderkombetar (qe konsiston ne perkthimin zyrtar te lejes se qarkullimit qe disponohet).

Ne rastin kur duan te kerkojne rezidencen ne gjendjen civile ne Itali ose kane me shume se nje vit qendrimi, qytetaret jokomunitare duhet te bejne konvertimin e lejes se qarkullimit te huaj ne lejen e qarkullimit italiane.

Ne rastin kur qytetari i perket nje shteti qe ka nenshkruar marreveshjken e konvertimit te lejes se qarkullimit me Italine, konvertimi eshte automatik[8].



Leshimi behet pa kontrollin e aftesive mendore, fizike te kerkuesit, te percaktuara nga kodi i qarkullimit rrugor[9], pa dhene asnje provim per qarkullimin me mjet.

Qytetaret qe vijne nga vende qe nuk kane nenshkruar me Italine marreveshjen mbi konvertimin automatik te lejes se qarkullimit, duhet te japin provimin teorik e praktik per marrjen e lejes se qarkullimit.

### Ku paraqitet kerkesa per konvertimin e lejes se qarkullimit?

Kerkesa per konvertimin e lejes se qarkullimit paraqitet prane zyres kompetente te Drejtorise se qarkullimit rrugor te krahines ku i interesuari ka rezidencen (mund te behet kerkesa edhe nepermjet zyrave te A.C.I)[10], duke paraqitur dokumentat e meposhtem:

- Certifikaten mjekesore te leshuar ose nga mjeku i njohur nga A.S.L – Sherbimi shendetesor lokal,[11], ose nga perfaqesuesi shendetesor (ne kete rast mund t'i drejtoheni edhe zyres se A.C.I
- Certifikaten e rezidences te shoqeruar me pulle prej 10,33 euro.



- Tre foto me format tesere, koherente, nga te cilat njera e autentikuar;
- Leja e qarkullimit e huaj dhe fotokopja e saj;
- Perkthimi i lejes se qarkullimit, i bere nga nje perkthyes i noterizuar dhe i autentikuar nga gjykata;
- Certificata gjygjesore (e shoqeruar me pulle € 10,33).

Pasi eshte bere kerkesa dhe dorezuar leja egzistuese e qarkullimit (kjo e fundit dergohet ne vendin e leshimit), i huaji do te marre lejen e qarkullimit italiane pa qene e nevojshme te jape provimet e parashikuara.

## Po ne rastin kur nderrohet vendbanimi?

Kushdo qe nderron vendbanimi ose banese, brenda 30 diteve duhet te komunikoje ne prefekturen kopetente nderrimin e komunes ose te baneses brenda se njejten komune.
Prefektura siguron nderrimin e adreses edhe mbi patente.





[6] Shih adresat ne fund te udhezuesit.

[7] Lejet e qarkullimit te leshuara nga shtetet perberese te Komunitetit Europian, jane te barazvlefshme me ato italiane.

[8] **Lista e shteteve, lejet e qarkullimit te te cilave mund te konvertohen** (e permiresuar ne shkurt 2003): Algjeria, Korea e jugut, Kroacia, Filipine, Islanda, Liban, Liechtenstein, Maqedonia, Malta, Maroku, Norvegjia, Poloni, Mbreteria e Monakos, Rumania, San Marino, Sllovenia, Sri-Lanka, Svizera, Taiean, Turqia, Hungaria.
Lista e sipershenuar eshte objekt ndryshimi i vazhdueshem. Per kete eshte e keshillueshme, ne raste ndryshimi, te konsultohet zyra e qarkullimit rrugor e krahines. Shih adresat ne fund te udhezuesit.

[9] **Ne Itali nuk mund te drejtojne mjete:**
- I semuri fizik ose mendor, me mangesi organike ose me mangesi mendore, anatomie dhe funksione qe bejne te veshtire drejtimin e mjetit makine ose motor qofte;
- Nje kriminel i njohur, profesionist ose per qejf, i vene nen masa sigurie personale ose masa te kujdesise, me prejashtim ne rastet kur jane plotesisht te riaftesuar;
- I denuari jo me pak se 3 vjet, kur me perdorimin e lejes se qarkullimit mund te kete kryer deme te te njejtes kohezgjatje.

[10] Shih adresat ne fund te udhezuesit.

[11] Per te ditur me shume mbi sistemin shendetesor italian o se cfare jane A.S.L, shih kap. N. 4: Shendeti dhe Ndihma mjekesore.



## 2.5 Cfare eshte autocertifikata?

*Autocertifikata eshte thjesht nje deklarate, qe njihet ndryshe edhe si "deklarate zevendesuese e certifikates", me anen e te ciles qytetari shenon nje seri te dhenash, gjendjesh e kushtesh, pa patur nevoje te paraqese certifikaten perkatese.*

Ka te njejten vlere kohore si edhe akti te cilin zevendeson.
Duhet te jete e nenshkruar nga qytetari te cilit i perket, pa pasur nevoje per noterizimin e firmes. Autocertifikata mund te prezantohet edhe nga nje person tjeter qe nuk eshte ai te cilit i perkasin te dhenat, mjafton qe deklarata te shoqerohet me fotokopjen e nje dokumenti njohjeje te personit qe e prezanton.

Mund te paraqesin auotocertifikate edhe qytetaret qe nuk i perkasin komunitetit europian, mjafton qe te kene nje leje qendrimi te rregullt ne Itali.

### Cfare mund te deshmohet me anen e autocertifikates?

Me autocertifikate mund te deshmohet:

- Data dhe vendi i lindjes;
- qytetaria;
- shfrytezimin e te drejtave politike e shoqerore;
- te qenurit ne jete;
- vendbanimi;
- gjendja familjare;
- i/e martuar, i/e vè, o gjendja e lire familiare;
- linda e nje femije;
- Vdekja e partnerit, e nje paraardhesi o pasardhesi (gjysherve, prinderve, femije, nipi, etj)
- Rregjistrimi ne rregjistra o lista te administrates publike;
- Perkatesia e nivelit profesional;
- Te pasurit te nje titulli ose te nje kualifikimi profesional; provime te mbajtura; te pasurit e nje titulli specializimi, aftesie, kursi, kualifikim teknik.;
- Te ardhurat dhe situata ekonomike (me objektivin per te perfituar nga ligjet ne fuqi), zgjidhjen e detyrimeve te vecanta me qellimin e zmadhimit te shumes korrisponduese.
- Poseidimi i kodit te rregjistrimit , nje llogarie dhe te cfaredo te dhene te rregjistruar ne rregjistrata gjendrjes gjygjesore;
- Gjendjen e punesimit, te pensionit dhe kategorine e pensionit, gjendjen si student;



- Te qenurit juridikisht perfaqesues i personit fizik e juridik, si mbikqyres, kujdestar ose nje gje e tille;
- Rregjistrimin prane shoqatash o fondacione shoqerore te cfaredo lloji;
- Persa i perket te gjithave detyrime ushtarake, duke perfshire edhe ato te cituara ne fleten e sherbimit ushtarak;
- Te mos pasjes ndjekje penale dhe te mos qenurit nen masa te kesaj natyre, te vendimeve civile dhe te masave amdministrativete rregjistruara ne librin e gjykates;
- Te mos qenurit i denuar apo nen ndjekje penale;
- Te jeteses ne ngarkim te dikujt tjeter;
- Te te gjithe te dhenave per te cilat i interesuari eshte ne dijeni;
- Te mos qenurit ne gjendje te likujdimit o deshtimit e te mos paraqitjes se kerkeses se koordinimit.

Per te vertetuar te dhenat qe lidhen me mbiemrin, emrin, vendin dhe daten e lindjes, qytetarine, gjendjen civile e rezidencen, eshte e mjeftueshme te paraqitet nje dokument njohjeje.
Rregjistrimi i te dhenave behet me anen fotokopjes te pa noterizuar te dokumentit qe paraqitet.
Nese dokumenti qe prezantohet, ka skaduar, i interesuari duhet te deklaroje ne nje hapesire ne te njejten flete te fotokopjes se dokumentit, qe ky i fundit mban te dhena qe nuk kane ndryshuar edhe pse vlera kohore eshte e kaluar.

Autocertifikata nuk mund te perdoret vetem per te dhena, cilesi ose fakte qe mund te vertetohen nga persona publike italiane (ose me mire nga zyrat e administrates publike ose nderrmarjeve qe merren me sherbimin publik).

### Cfare nuk mund te autocertifikohet?

Nuk mund te zevendesohen nga autocertifikata dokumentat e meposhtem:
- Certificata mjekesore, shendetesore, veterinare;
- Certificata te origjines dhe te konformitetit me normat e komunitetit;
- patente e marka.





# 3 shërbimet shoqërore

## 3.1 Kush siguron në Piemonte asistencën shoqërore dhe shëndetësore?

*Në Piemonte, shërbimet shoqërore dhe shëndetësore mund të menazhohen në forma të ndryshme, në varësi të vendit të rezidencës.*
*Mundet të sigurohen nga Konsorcet e Komunave, Komunat vetë apo Shoqëritë Shëndetësore Lokale (ASL).*
*Entet që sigurojnë shërbimet socio-shëndetësore quhen* ***Entet Administruese****.*

### Si mund të gjendet emri i saktë i Entit Administrues tek i cilit duhet të drejtoheni?

Duhet të drejtoheni pranë Komunës së rezidencës që informon për Entin Administrues më të afërt[1].

### Kush mund të kërkojë asistencë shoqërore?

Të gjithë qytetarët e huaj në një situatë të rregullt.
Të huajt pa leje qëndrimi dhe apolidëve u garantohet ndihma e shpejtë dhe urgjenca.

### Cilët janë shërbimet shoqërore që ofrohen nga Entet Administruese?

- Informacione të përgjithëshme përmes Sekretariatit Social;
- Asistencë ekonomike në bazë të rregulloreve të brendëshme të Entit Administrues;
- Shërbime asistenciale familjare në ndihmë të qëndrimit pranë familjes apo në shtëpi të personave pjesërisht apo totalisht jo autosufiçentë;
- Shërbime edukimi në shtëpi në ndihmë të personave, veçanërisht minorenëve, në rrezik emargjinimi shoqëror;
- Shërbime lidhur me tutelimin e minorenëve në raport me Autoritetet Gjygjësore (raste birësimesh);
- Shërbime në mbrojtje të minorenëve të huaj të pashoqëruar nga familjarët;
- Shërbime asistenciale në ndihmë të personave me handikap;
- Asistencë personave të moshuar (asistencë shtëpiake, pranimin në qëndrat ditore ose azil);
- Mediacion kulturor, familiar, kurse përgatitje profesionale, etj.

Jo të gjithë Entet Administrues ofrojnë të njëjtat shërbime, e mbi të gjitha, Ente të ndryshëm kanë modalitete të ndryshme për erogimin e këtyre shërbimeve.





### Si mund të njihen me saktësi shërbimet që ofron Enti Administrues?

Përmes **"Kartës së Shërbimeve"** që liston të gjitha shërbimet që Enti Administrues kompetent mund të erogojë, dhe karakteristikat që duhen përmbushur për të pasur këto shërbime.

Karta e shërbimeve mund të kërkohet pranë Entit Administrues të Komunës apo qytetit tuaj.

Në rast se ky dokument nuk është i disponueshëm, është e mundur të kërkoni informacione pranë Sekretariatit Social të Entit Administrues.

[1] Shih adresat në fund të Udhëzuesit.











# 4 shërbimi shëndetësor dhe asistenca mjekësore

## 4.1 Çfarë është Shërbimi Shëndetësor Kombëtar?

*Shërbimi Shëndetësor Kombëtar (S.S.N.) është një bashkësi strukturash që tutelojnë shëndetin dhe sigurojnë asistencën shëndetësore të gjithë qytetarëve, italianë e të huaj me qëndrim të rregullt, pa asnjë dallim në trajtim.*
*Asistenca shëndetësore i takon, përvec të regjistruarve, edhe familjarëve në ngarkim më leje qëndrimi të rregullt.*
*Për të pasur mundësinë e asistencës shëndetësore duhet në rradhë të parë të regjistroheni në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar.*

Regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar është i **detyrueshëm:**

- për kë jeton e punon rregullisht në Itali;
- për kë jeton e është rregullisht i regjistruar në listat e kolokimit;
- për kë ka kërkuar renovimin e lejes së qëndrimit për punë me kontratë dhe të pavarur, motive familjare, strehim politik, pritje për birësim e në rast kërkese për nënshtetësinë italiane.



Regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar është **fakultativ** (duke paguar një kontribut vjetor):

- Për të huajt me leje qëndrimi për motive studimi;
- Për kë ka leje qëndrimi të rregullt për punë pranë familjeve pa pagesë por me shpenzime të paguara nga familjet ku jetojnë.



### Ku kryhet regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar?

Regjistrimi mund të kryhet pranë Kompanive Shëndetësore Lokale (A.S.L)[1] të vendit ku jetoni.
A.S.L. janë struktura administrative dhe operative të Sistemit Shëndetësor Kombëtar.

### Për çfarë shërben tesera shëndetësore?

Tesera shëndetësore është një dokument që provon regjistrimin në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar.
Në të shënohen emri i të asistuarit dhe ai i mjekut të familjes (shih më poshtë).
Është e rëndësishme të paraqitet tesera për të mundësuar shërbimet sanitare e shërbimet e tjera.

### Për sa kohë është e vlefshme tesera shëndetësore?

Vlefshmëria e teserës shëndetësore është e njëjtë me atë të lejes së qëndrimit.



Për refugjatët politikë të njohur nga konvencioni i Gjenevës 1951, kohëzgjatja është pakufi.
Regjistrimi nuk është më i vlefshëm në rast revokimi, anullimi, skadimi dhe mos renovimi të lejes së qëndrimit, dmth në rast se largimi ligjor nga Italia është kryer.
I interesuari mund të shfrytëzojë ende regjistrimin në rast se paraqet dokumentacionin në lidhje me çështjen gjygjësore të hapur ndaj masave të marra në dëm të tij.

### Çfarë dokumentash janë të nevojshëm për regjistrimin në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar?

- Dokumenti i identitetit;
- Leja e qëndrimit;
- Kodi fiskal;
- Certifikata e rezidencës ose në mungesë, një autoçertifikatë banimi e plotësuar në prani të një funksionari të A.S.L.-it.



### Çfarë të drejtash jep regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar?

Regjistrimi jep të drejtë për:
- Zgjedhjen e mjekut të përgjithshëm si "mjek i familjes", ose të pediatrit;
- Kurat e specializuara dhe analizat laboratorike;
- Shërbime të Urgjencës;
- Shtrimi falas në spitalet publike dhe me konvencion;
- Asistencë farmaceutike.



### Sa kushton regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar?

Regjistrimi është falas për:
- të papunët me leje qëndrimi të rregullt dhe të regjistruar në Bankën e të Dhënave pranë Zyrave të Punës[2];
- refugjatët me çertifiatë të rregullt mbi statusin e refugjatit e që kërkon strehim;
- shtetasit e martuar e në ngarkim të një shtetasi italian;
- minoren me prind rezident në Itali ose me prind të përfshirë në një nga kategoritë e përshkruara më sipër.

[1] Shih adresat në fund të udhëzuesit.

[2] Shih kap. 5. Puna dhe Sigurimet Shoqërore.





Regjistrimi paguhet me:

- kontributet e derdhura nga punëdhënësi për punonjësit e tij me leje të rregullt qëndrimi;
- derdhjen e kuotës vjetore fikse për profesionistët e lirë, punonjësit e pavarur, apo studentët me leje të rregullt qëndrimi.

## 4.2 Kush ka të drejtë për mjekun e familjes dhe pediatrin? Çfarë shërbimi garantojnë?

*Të gjithë qytetarët kanë të drejtë për asistencën e dhënë nga një mjek i përgjithshëm. Për fëmijët nga 0 në 14 vjec parashikohet asistenca e një pediatri në Komunat ku pediatri është prezent.*
*Nga mosha 6 vjeç nëse dëshirojnë, prindërit mund të zgjedhin një mjek të përgjithshëm për fëmijët e tyre.*

Zgjedhja e mjekut apo pediatrit kryhet pranë zyrave ku lëshohet tesera shëndetësore, duke konsultuar listën e mjekëve të disponueshëm.
Marrëdhëniet mes mjekut dhe qytetarit bazohen në një raport besimi.
Mjeku mund të ndryshohet brenda për brenda listës së të njëjtës ASL.



Mjeku i familjes dhe pediatri garantojnë:

- Vizita ambulatorike dhe në shtëpi;
- Receta per medikamente;
- Kërkesa për vizita të specializuara dhe analiza;
- Lëshim raporti mjekësor për punonjësit, femijët që duhet të rikthehen në shkollë pas sëmundjes, apo që duhet të pranohen në çerche, kopësht, në shkollë 8-vjeçare.

Mund t'i drejtoheni mjekut të familjes edhe për t'u këshilluar e për të marrë mendim mbi shëndetin personal, duke parandaluar lindjen e sëmundjeve.

Mjeku dhe pediatri kryejnë aktivitetin e tyre në orare dhe ditët që janë publikuar në hyrje të klinikave të tyre.

**Të gjitha shërbimet e mjekut të familjes dhe pediatrit janë falas.**



## 4.3 Ku duhet të drejtoheni për kurat e specializuara dhe analizat laboratorike (gjaku, radiologjike, etj.)?

*Duhet t'i drejtoheni zyrës së prenotimeve të A.S.L.-it.*

Duhet të paraqisni teserën e regjistrimit pranë S.S.N. dhe kërkesën e mjekut të famijes apo pediatrit.

Kjo kërkesë nuk është e nevojshme vetëm për vizitat e mëposhtëme:
- odontoiatrike,
- gjinekologike,
- tek okulisti.

Prenotimi është pothuaj gjithnjë i nevojshëm.
Në zyrën e prenotimit të A.S.L.-ve përcaktohen vendi, data dhe ora kur do të kryhet vizita.
Kurat e specializuara dhe analizat laboratorike kryhen pranë ambulatorëve publikë e privatë të konvencionuar.

Për vizitat e specialzuara apo analizat laboratorike është parashikuar pagesa e një kuote të shpenzimit nga ana e qytetarit, quajtur ndryshe **"ticket".**
Disa kategori të asistuarish (qytetarë me të ardhura të ulëta, invalidë civilë, gra shtatëzëna, etj) mund të përjashtohen nga pagesa e Ticket-it.

Për informazione të mëtejshme duhet ë drejtoheni pranë Zyrave të Marëdhënieve me Publikun të A.S.L.-it, ku mundet gjithashtu të paraqesni ankesa apo kërkoni informacione mbi gjithë çka të bëjë me tutelën e utentëve.

4

## 4.4 Ku duhet të drejtoheni në rast Urgjence?

*Në raste urgjence (aksidente, apo çfarëdo lloj situate rreziku për jetën) është e mundur të shkoni pranë Urgjencës së spitalit ose të kërkoni ndërhyrjen e mjekut duke telefonuar në numrin **118** që është në funksionim gjatë 24 orëve.*

Në rast sëmundje është e mundur t'i kërkoni mjekut të familjes kryerjen e një vizite pa pagesë në shtëpi. Ndërsa gjatë orëve të natës (nga ora 20.00 deri në orën 8.00), të shtunën pasdite (nga ora 14.00), të djelën e të gjitha ditët e tjera festive është aktiv **Shërbimi Asistencor i Vazhdueshëm (roja mjekësore)**.

Edhe për këtë shërbim mund të telefonini në numrin falas **118**.



## 4.5 Ku blihen medikamentet?

*Në Itali medikamentet shiten ekskluzivisht në farmaci.*
*Vetëm mjeku i familjes, pediatri dhe mjeku që kryen vizitat e specializuara munden të lëshojnë receta apo deklaratë të shkruar sipas modeleve të caktuara (**recetë**).*
*Përmes recetës, që i duhet dhënë farmacistit, mjeku autorizon blerjen e ilaçeve.*
*Receta ka vlerë 30 ditore që nga dita e lëshimit.*

Orarët dhe periudhat e pushimeve të farmacive janë të shënuara në kalendarët që publikohen periodikisht në çdo farmaci.
Gjatë natës dhe ditëve festive janë operative farmacitë e natës ose **"roje"**.
Cdo farmaci është e detyruar të ketë të publikuar informacionet mbi farmacinë e turnit më të afërt.

## 4.6 Çfarë janë Konsultoret Familiare dhe Pediatrike[3]?

*Janë qëndra për tutelimin e shëndetit fizik dhe psiqik të gruas, fëmijës e të familjes, të pranishëm në cdo A.S.L.*



### Çfarë shërbimesh ofrojnë?

- Asistencë ndaj gruas shtatëzënë (vizita ostetriko-gjinekologike, kurse pregatitje për lindjen dhe mëmësinë);
- Asistencë grave që mendojnë të ndërpresin vullnetarisht shtatëzaninë (aborti);
- Asistencë gjinekologjike bazë për sëmudjet lidhur me marrëdhëniet seksuale, sterilitetin dhe fertilitetin;
- Asistencë grave me probleme të menopauzës;
- Konsulencë kontraceptive për të parandaluar shtatëzani të padëshiruara;
- Parandalim dhe diagnostikim i tumoreve të aparatit gjenital femëror;
- Asistëncë e këshillim për problemet psikologjike e sociale lidhur me marëdhëniet bashkëshortore, prindër-fëmijë, shtatëzanisë, lindjes, marrëdhënieve fizike;
- Problematikave lidhur me ndarjen, keqtrajtimin dhe dhunës në familje;
- Informacione mbi birësimet dhe kujdesarisë;
- Shëndeti i fëmijës para lindjes së tij, të porsalindurit e të fëmijës në vitet e para të jetës.





Të gjitha shërbimet e konsultoreve janë falas.
Asnjë autorizim apo kërkesë e mjekut të familjes është e nevojshme, mjafton të merret takim (përmes telefonit).
Shërbiet u drejtohen edhe grave në mungesë të lejes së qëndrimit.

## 4.7 A është e lejuar me ligj në Itali ndërprerja e vullnetëshme e shtatëzanisë (aborti)?

*Po, në Itali ekziston një ligj (ligji 194/1974) që disiplinon dhe pranon ndërprerjen e vullnetëshme të shtatëzanisë brenda* ***90 ditëve të para.***



### A është e mundur ndërprerja e shtatëzanisë pas 90 ditëve të para?

Po, por vetëm në disa raste:
- kur shtatëzania ose lindja përbëjnë rrezik për jetën e gruas;
- kur fëmija paraqet deformime që përbëjnë rrezik serioz për shëndetin fizik e mendor të nënës.

### Ku duhet të drejtoheni në rast aborti?



Duhet të drejtoni në një Konsultore publike, ose një strukture socio-sanitare, ose një mjeku të besuar.

Konsultori, struktura socio-sanitare, apo mjeku kanë për detyrë të:
- garantojnë vëzhgimet mjekësore të duhura;
- vlerësojnë, duke respektuar lirinë dhe dinjitetin e gruas, që bashkë me të, babain e fëmijës (kur gruaja është dakort), rrethanat që çojnë në vendimin për ndërprerjen e shtatëzanisë;
- krijojnë mundësinë që gruaja të bëjë të njohura të drejtat e saj si punëtore e nënë;
- promovojë çdo lloj ndërhyrje oportune për të mbështetur gruan, duke i ofruar ndihmën e duhur, si gjatë shtatëzanisë, ashtu edhe paslindjes.

[3] Shih adresat në fund të udhëzuesit.



Kur mjeku i konsultores, i strukturës shëndetësore, apo mjeku i strukturës socio-sanitare vë re' arsye për të cilat rezulton e domosdoshme **ndërhyrja urgente**, lëshon menjëherë një çertifikatë që vërteton urgjencën.
Me këtë çertifikatë gruaja mund të paraqitet në një nga qëndrat e autorizuara që praktikojnë ndërprerjen e shtatëzanisë.

Nëse nga vizita nuk rezulton urgjenca, në fund të saj e në bazë të kërkesës së gruas për të ndërprerë shtatëzaninë, mjeku i konsultores, strukturës shëndetësore apo mjeku i besuar lëshon kopje të një dokumenti që tregon gjendjen e shtatëzanisë dhe kërkesën e gruas, dhe e fton atë të marrë 7 ditë për t'u menduar.
Pasi kalojnë të shtata ditët, gruaja mund të paraqitet pranë qëndrave të autorizuara për ndërprerje të barrës duke paraqitur dokumentin e lëshuar nga mjeku.

## Kush mund të kërkojë ndërprerjen e shtatëzanisë?

Kërkesa duhet bërë personalisht nga gruaja.

Në rast se gruaja është **në moshë më të vogël se 18 vjeç** kërkohet miratimi i tutorit ligjor.

Megjithatë, **gjatë 90 ditëve të para**, kur:
- paraqiten motive serioze që ndalojnë apo që pengojnë këshillimin me tutorët ligjorë;
- ose kur këta persona refuzojnë ose shprehim mendime të kundërta;

konsultori, struktura socio-sanitare apo mjeku i besuar, brenda 7 ditëve nga kërkesa, i dërgojnë gjykatësit të zonës ku operojnë, një relacion mbi pozicionin e tyre.
Gjykatësi, brenda 5 ditëve, pasi ka dëgjuar gruan dhe duke marrë parasysh vullnetin e saj, mund të autorizojë ndërprerjen e shtatëzanisë.

Në rastin kur mjeku vërteton urgjencën e ndërhyrjes për shkak të rrezikut që përbën për jetën e minorenes, ai mund të çertifikojë ekzistencën e kushteve që justifikojnë ndërprerjen e barrës, pavarësisht nga aprovimi ose i jo i tutorëve ligjorë të vajzës e pa qënë nevoja t'i drejtohet gjykatësit.
Kjo çertifikatë lejon ndërhyrjen urgjente, e nëse është i nevojshëm, edhe shtrimin në spital.
Pas **90 ditëve të para**, për minorenet aplikohen proçedurat e njëjta si për ato me moshe mbi 18 vjeç, pavarësisht nga aprovimi ose jo i tutorëve ligjorë.





## 4.8 A është e mundur në Itali mosnjohja e fëmijës që në lindjen e tij?

*Po, në Itali gruja ka të drejtë të lindë pa e njohur fëmijën e pa bërë të njohur emrin e saj në çertfikatën e lindjes (dmth pa i dhënë mbiemrin e saj fëmijës).*

Në këtë rast gruaja ka të drejtë që emri i saj të mbahet sekret; dhe është kategorikisht e ndaluar që personat të cilët, për arsye pune janë në dijeni të emrit të nënës, ta tregojnë atë.
Nëse e bëjnë, kanë thyer ligjin.

Në rast se fëmija nuk njihet nga nëna, gjykata nuk mund të bëjë kërkime për të gjetur të atin.

## 4.9 Ku mund të drejtoheni për asistencën shëndetësore për fëmijët?

Asistenca për fëmijët e huaj sigurohet:

- përmes mjekëve pediatër që mund të zgjidhni në cdo A.S.L. (që mund të arrihet edhe në rast se nuk jeni në rregull me dokumentat);
- përmes konsultoreve pediatrike dhe qëndrave të vaksinimit.







## 4.10 Cilat janë vaksinat e detyrueshme dhe fakultative në Itali?

*Në tabelën në vijim paraqiten vaksinat e detyrueshme dhe fakultative si dhe periudha kur duhen bërë.*

| **Vaksinat e detyrueshme**<br>Mosha | Poliomieliti | Difteriti<br>Tetanoi<br>Pertosse | Hepatiti B |
|---|---|---|---|
| 3 muajsh | ● | ● | ● |
| 5 muajsh | ● | ● | ● |
| 11 muajsh | ● | ● | ● |
| 12-15 muajsh | | | |
| 3 vjeç | ● | | |
| 5-6 vjeç | | ● | |
| 12 vjeç | | | ● *(3 doza)* |

| **Vaksinat fakultative**<br>Età | Haemophilus<br>influenzae tip b | Fruthi<br>Rosolia<br>Parotite |
|---|---|---|
| 3 muajsh | ● | |
| 5 muajsh | ● | |
| 11 muajsh | ● | |
| 12-15 muajsh | | ● |
| 3 vjeç | | |
| 5-6 vjeç | | |
| 12 vjeç | | ● *lajmërim i mundshëm* |

Për të rriturit këshillohen vaksinat kundër tetanozit (1 çdo 10 vjet pas ciklit bazë) dhe hepatitit viral të tipit B.

## 4.11 Ku duhet të drejtoheni për vaksinimin?

*Për të kryer vaksinimin e detyrueshëm mund t'u drejtoheni **Qëndrave të Vaksinimit**, **Konsultorit Pediatrik** ose **Shërbimit të Higjenës Publike** të **A.S.L.** Shërbimi është falas.*

Një çertifikatë vaksinimi kërkohet si kusht për pranimin në shkollën fillore, kopësht, çerdhe e për t'u pranuar në kampet verore, aktivitetet sportive.

**Vaksinimi në fëmijëri është një mënyrë e sigurt dhe efikase për mbrojtjen personale dhe të popullsisë nga disa lloje sëmundjesh të rënda.**

### A është e nevojshme t'i nënshtroheni vaksinimit kur ktheheni në vendin tuaj të lindjes?

Për ata që shkojnë në vendin e tyre të lindjes këshillohet dhe është e rëndësishme parandalimi i sëmundjeve infektive (**malaria, ethet e verdha, hepatiti viral A**).

Për këtë profilaksi, të huajt mund t'i drejtohen mjekut të tyre kurues, qëndrave mjekësorë për udhëtarët, e nëse nuk janë të pajisur me leje qëndrimi, qëndrave I.S.I. (Qëndra të Informimit Shëndetësor, shih më poshtë) që do t'ju adresojnë tek strukturat më të përshtatëshme.

4



## 4.12 A kanë të drejtë të huajt në Itali për asistencën shëndetësore?

*Të gjithë të huajt e pranishëm në Itali kanë të dretjën e asistencës shëndetësore primare.*

### I huaji me leje të rregullt qëndrimi, por jo i regjistruar në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar

Në strukturat shëndetësore të akredituara nga vetë Shërbimi Shndetësor Kombëtar sigurohen:

- **Shërbimet spitalore urgjente** (në rrugë ambulatorike, shtrim ose day hospital – shtrim ditor), për të cilat pagesa bëhet në momentin e daljes nga spitali;
- **Shërbimet shëndetësore jo urgjente**, që mund të programohen e për të cilat nuk kalohet nga Urgjenca, qoftë ambulatorike, qoftë shtrime në spital (për shembull tonsillectomia-heqja e bajameve), **me parapagesë sipas tarifave të përcaktuara.**

Shërbimet mjekësore për personat **e siguruar përmes institucioneve të huaj**, disiplinohet nga marrëveshjet ndërkombëtare.

### I huaji që nuk është në rregull me normat e hyrjes e të qëndrimit

Të huajt pa leje qëndrimi, dmth, të huajt që janë përkohësisht në Itali (S.T.P.), u garantohen asistenca shëndetësore bazë.

Në strukturat publike e private të akredituara nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar sigurohen:

- kurat ambulatorike dhe spitalore urgente o primare, edhe pse të vazhdueshme, për sëmundje apo aksidente;
- shërbimi shëndetësor bazë;
- shërbimi gjatë shtatëzanisë dhe pas lindjes;
- shërbime për ndërprerjen me dëshirë të shtatëzanisë (aborti);
- mbrojtje të shëndetit të fëmijës;
- vaksinat e parashikuara nga normativa dhe ato që kryhen gjatë ndërhyrjeve parandaluese të autorizuara nga rajoni;
- ndërhyrjet profilaktike ndërkombëtare;
- profilaksia, diagnostikimi dhe trajtimi i sëmundjeve infektive;
- shpërndara falas e medikamenteve kryesore.



Të sëmurit i sigurohet siqodoftë cikli terapeutik dhe rehabilitues i plotë që mund të çojë në zgjidhjen e situatës.

Të huajit pa leje qëndrimi ASL- i zonës së tij i lëshon një **teserë me kodin rajonal sigluar S.T.P.** (i huaj me qëndrim të përkohshëm) që duhet treguar për të mundur shërbimet shëndetësore ndaj personit.

Kjo teserë ka vlerë semestrale dhe është e renovueshme në rast qëdrimi të të huajit në territorin kombëtar.

### A përfiton i huaji pa leje qëndrimi ndihmë ekonomike, në rast nevoje, për të pasur shërbim mjekësor?

Shërbimet që S.S.N. kryen mbi qytetarët e paregjistruar nuk kanë kosto tjetër për të huajt pa leje qëndrimi dhe me të ardhura ekonomike të pamjaftueshme, përvecse  kuotave të përcaktuara që mbulojnë një pjesë të kostos së shërbimit (ticket). Statusi i pamundësisë ekonomike tregohet në momentin e lëshimit të kodit rajonal **S.T.P.** (i huaj me qëndrim të përkohshëm), përmes nënshkrimit të një



deklarate që është e vlefshme për 6 muaj.

I huaji në pamundësi ekonomike dhe pa leje qëndrimi, është i përjashtuar edhe nga pagesa e kuotës së paracaktuar në mbulim të një pjese të kostos së shërbimit (ticket) për sa më poshtë vijon:

- Shërbimi shëndetësor bazë;
- urgjencat;
- shtatëzaninë;
- patologjitë që përjashtohen apo persona që përjashtohen për shkak të moshës o të prekur nga një gjendje e rëndë invalidateti.

**Përdorimi nga ana e të huajit pa leje qëndrimi të gjitha shërbimeve shëndetësore nuk nënupton asnjë denoncim pranë autoriteteve gjygjësore prej autoriteteve shëndetësore.**



## Cfarë janë Qëndrat ISI?

Janë qëndrat e **Informacionit Shëndetësor** për të huajt e paregjistruar ne Shërbimin Shëndetësor Kombëtar, që Rajoni Piemonte ka ngritur në rrugë esperimentale.

"Të Huajt me Qëndrim të Përkohshëm" (S.T.P.) mund të gjejnë pranë Qendrave ISI një  ndihmesë të rëndësishme si për akspektet terapeutike ashtu edhe për shërbimet preventive që ofron SSN, e shpesh edhe për aspektet burokratike falë punës së mediatorit kultutor.







Më poshtë jepet lista e Qëndrave të Informacionit Mbi Shëndetin e Imigrantëve (Centri ISI) aktive në Piemonte.

| | | |
|---|---|---|
| **Asti** ASL 19 | *Via Orfanotrofio 15/17* | 0141-392743 |
| **Biella** ASL 12 | *Via Don Sturzo 20* | 015-3503681/350655 |
| **Borgomanero** (No) ASL 13 | *Viale Zoppis 6* | 0322-848343 |
| **Bussoleno** (To) ASL 5 | *Via Tonelli 1* | 0122-48196 |
| **Chieri** (To) ASL 8 | *Via San Giorgio 20* | 011-94294682 |
| **Collegno** (To) | *Via Oberdan 10* | 011- 4017814-44 |
| **Cuneo** ASL 15 | *Via C. Boggio 14* | 0171-450271/270 |
| **Domodossola** ASL 14 | *Corso Dissegna 29* | 0324-491620 |
| **Novara** ASL 13 | *Via Dei Mille 2* | 0321-374573 |
| **Omegna** (Vb) ASL 14 | *Via Mazzini 117* | 0323-868355/166 |
| **Orbassano** (To) ASL 5 | *Viale Papa Giovanni XIII 11* | 011-9036461/32 |
| **Torino** ASL 2 | *Via Tofane 71* | 011-70952593/95 |
| **Torino** ASL 4 | *Largo Dora Savona 24* | 011-2403717/12 |
| **Torino** ASL 1 | *Via San Domenico 22/c* | 011-5663050 |
| **Vercelli** ASL 11 | *Via Crosa 4* | 0161-593622/16 |











# 5 punësimi dhe sigurimet shoqërore

## 5.1 Ku duhet të drejtoheni kur kërkoni punë?

*Zyrave të punës*[1]

### Cfarë shërbimesh ofrojnë Zyrat e Punës?

Zyrat e Punës:

- Krijojnë kontakte mes punëtorëve dhe punëdhënësve;
- Ofrojnë informacione mbi:
  tregun e punës,
  mundësitë e punsimit,
  ofertën formative,
  normativën në fuqi;
- Ofrojnë mundësinë e kryerjes së praktikave formative (dmth periudha pregatitje në fushën profesionale) bazuar në konvencionet e lidhura me punëdhënësit (praktikat e promovuara nga Zyrat e Punës kanë një kohëzgjatje nga 3 në 6 muaj; nuk mund të konfigurohen si marëdhënie pune e nuk parashikojnë pagesë).

### Kujt i drejtohet shërbimi?

- Të papunëve dhe atyre që kanë kohë që kanë mbetur pa punë;
- Grave që kërkojnë te ri-hyjnë në tregun e punës;
- Të papunëve që përfitojnë trajtime prvidenziale;
- Personave me handikap;
- Të rinjve të papunë dhe cirakëve.





### Cilët janë dokumentat e nevojshme për të pasur munësinë e shërbimeve të Zyrave të Punës?

- Dokument identiteti
- Kodi fiskal;
- Leje qëndrimi të vlefshme për arsye:
  **pune** (me kontratë, të pavarur, sezonale);
  **familjare**;
  **strehim politik**;
  **studim** (kjo leje qëndrimi lejon të punohet për një total javor prej 20 orësh në javë);
  **familjare**, **moshe minore** ose **birësim** për minrenët e huaj që janë nën detyrimin shkollor;

- Këshillohet të dorëzohet edhe përkthimi i notifikuar nga Zyra e Vërtetimeve të Titujve të Prefekturës, të diplomave të marra jashtë Italisë.

## 5.2 Cfarë mbulojnë kontributet shoqërore dhe përse është e rëndësishme të derdhen?

*Sistemi i sigurimeve shoqërore parashikon qe punonjësi të tutelohet në raste të caktuara si:*

- sëmundje,
- shtatëzani,
- pleqëri,
- pamundësi fizke e mendore,
- pushimi nga puna e për rrjedhojë, papunësie,
- aksidente ne punë e sëundje profesionale.

Parashikon gjithashtu një sërë instrumentash në mbrojtje të familjës së punonjësit.

Për të gjitha këto është e nevojshme që të kryhet derdhja e kontributeve shoqërore.

### Kush është i detyruar të derdhë sigurimet shoqërore?

Për **punonjësit me kontratë** punëdhënësi është i deturuar që, përvecse pagesës sipas kontratës, të derdhë edhe kontributet shoqërore.

**Punonjësit e pavarur**, si për shembull tregtarët, duhet t'i kryejnë vetë veprimet për derdhjen e kontributeve shoqërore.

### Përse është e rëndësishme që punonjësi jo komunitar të derdhë kontributet shoqërore?

Sepse punonjësi jo komunitar që në Itali ka një aktivitet **të rregullt** pune për të cilën akreditohen kontribute, ka **të njëjtat të drejta** me punonjësit e tjerë. Mund të ketë, duke plotësuar pikat e kërkuara, të drejtën e shërbimeve të parashikuara nga legjislacioni italian.

[1] Shih adresat në fund të udhëzuesit.



## Cilët janë Entet kryesore për shërbimet previdenciale?

**INPDAP** (Instituti Nacional i Sigurimeve për Punonjësit e Administratës Publike), që merret me tutelën previdenciale të punonjsve publikë.

**INAIL** (Instituti Nacional i Sigurimeve për Aksidentet në Punë) që tutelon punonjësit me kontratë që pësojnë aksident gjatë punës ose me sëmundje profesionale, duke u garantuar shërbimet e nevojshme ekonomike dhe shëndetësore.

**INPS** (Instituti Nacional i Sigurimeve Shoqërore) që është enti kryesor që siguron **punonjësit privatë**, qoftë me kontratë, qoftë të pavarur, dhe që i tutelon gjatë pleqërisë, në rast papunësie, shtatëzanie, sëmundje, duke u garantuar kompensim në zëvendësim të rrogës.

## Ku duhet paraqitur kërkesa për kompensimet prej INPS?

Pranë Agjencisë së INPS-it kompetente për territorin në bazë të rezidencës/banimit së interesuarit, në rast shërbish të paguara drejtpërsëdrejti nga INPS.
Në rastin kur shërbimet duhën paguar nga punëdhënësi për llogari të INPS-it, kërkesat duhet të paraqiten nga vetë punëdhënësit e në disa rastë nga të dyja palët.

Kërkesat mund të dërgohen edhe me poste ose përmes **Patronateve**[2] të autorizuara që, me ligj, ofrojnë konsulencë falas për punonjësit gjatë plotësimit të praktikave providenciale.



Lista e Agjencinve të INPS-it në bazë të rezidencës/banimit mund të gjendet në internet, në adresën **www.inps.it/AgendaSedi**

Pjesa më e madhe e modeleve të kërkesës (bashkë me udhëzimet për plotesimin e saj dhe dokumentat që duhen bashkangjitur) dhe modulistika specifike janë të disponueshme si pranë sporteleve të Agjencive INPS, ashtu dhe në adresën internet **www.inps.it**, nën zërin "moduli".



## Në rastet kur punonjësi kthehen në vendin e tij, cfarë ndodh me kontributet e derdhura INPS-it?

Kontributet e derdhura gjatë periudhës së punës në Itali ruhen në arkivat e INPS-it dhe përbëjnë një pozicion asikurativ për cdo punonjës.
Kjo mund të riaktivizohet në rast rifillimi pune në Itali ose për likuidimin e pensionit.

## 5.3 Cfarë ndodh në rast se punonjësi sëmuret?

*Në rastet kur punonjësi sëmuret është i parashikuar* ***kompensimi për semundje****.*
*Është një kompensim ekonomik që lejon që punonjësi të marrë një pjesë të pagesës së tij edhe në rast mungese për shkak sëmundje.*
*3 ditët e para të sëmundjes paguhen nga punëdhënësi.*
*Nga dita e katërt, për një periudhë maksimale prej 180 ditësh në vit, pagesa kryhet nga INSP.*

### Kujt i takon kompensimi për sëmundje?

- Punëtorëve ose nëpunësve të sektorit privat;
- Të papunëve ose të pezulluarve nga puna (që i përkasin kategorive të sipër-përmendura), në rastet kur pushimi apo pezullimi është kryer jo më shumë se 60 ditë nga fillimi i sëmundjes.

Për punonjësit me kontratë afat shkurtër, e drejta për kompensim ekonomik në rast sëmundje ndërpritet me ndërprerjen e marëdhënieve ë punës.

5

### Si merret kompensimi për sëmundje?

Punonjësi duhet të marrë nga mjeku kurues raportin mjekësor në dy kopje. Brenda dy ditëh nga data e lëshimit të raportit mjekësor, një kopje duhet dërguar pranë zyrës së INPS-it përkatëse (asaj të rezidencës) dhe kopja tjetër punëdhënësit.

Është e rëndësishme që raporti të plotësohet qartë e sipas udhëzimeve

Punonjësi i sëmurë duhet të qëndrojnë në shtëpi e në dispozicion për ndonjë kontroll të mundshëm nga mjekët e INPS-it apo të A.S.L., në orarët e mëposhtëme: nga ora 10 në orën 12 dhe nga ora 17 në orën 19.

Në rast mungese pa arsye, parashikohet humbja e kompensimit.

Nëse gjatë periudhës kur merret kompensimi për sëmundje punonjësi transferohet në një adresë ndryshe nga ajo komunikuar në raportin mjekësor, kjo duhet bërë e ditur INPS-it dhe punëdhënësit.

Nëse gjatë sëmundjes, punonjësi jo komunitar dëshiron të dalë jashtë vendit ose në vendin e tij për kurim apo asistencë, duhet pikësëpari kërkojë autorizimin zyrës së INPS-it.

[2] Shih adresat në fund të udhëzuesit.



## 5.4 Cilët janë shërbimet në mbrojtje të shtatëzanisë?

Sistemi ynë previdencial parashikon modalitete të ndryshme për mbrojtje të nënës dhe babait:

- Kompensim për shtatëzaninë;
- Shkëputje ditore për të asistuar fëmijët;
- Leje në rast sëmundje të fëmijës;
- Cek për shtatëzaninë
- Cek për shtatëzaninë lëshur nga Komuna.

**Ligji italian parashikon përvec të tjerave, bllokimin e pushimit nga puna të gruas në fillim të shtatëzanisë derisa fëmija të mbushë 1 vjec, me përjastim të rasteve kur largimi nga puna vjen për pasojë të skadimit të kontratës së punës.**



## 5.5 Cfarë është kompensimi për shtatëzaninë[3]?

*Është një kompensim zëvendësues i pagesës që i paguhet grave që shkëputen përkohësisht nga puna për shkak të shtatëzanisë e puerperio (periudha që vjen pas lindjes e që konsiston në kthimin e gruas në gjendje normale, e që zgjat afërsisht 60 ditë).*

### Kujt i takon kompensimi për shtatëzani?

- Nënave në marëdhënie pune;
- Grave që shërbejnë në familje që kanë derdhur kontribute për të paktën 1 vit gjatë 2 viteve përpara periudhës së mungesës detyrueshme nga puna për shkak të shtatëzanisë, ose të paktën 6 muaj kontribute gjatë vitit pëprpara mungesës;
- Punotoret e bujqësisë që kanë kryer një minimum prej 51 ditësh pune gjatë vitit përpara periudhës së mungesës së detyruar;
- Punonjëset e pavarura që rezultojnë të regjistruara në listat e artizanëve apo tregtarëve, kultivatorëve apo ndihmësve e sezonalëve, përpara periudhës së lejes së barrës, e që kanë paguar kontributet shoqërore.



### Për sa kohë merret kompensimi për shtatëzaninë?

Kompensimi për shtatëzaninë **për lejen e detyrueshme** merret për një periudhë **maksimale 5 muajshe**;
për **leje fakultative**, për një periudhë jo më shume se **11 muaj** që mund të përdoret gjatë 8 viteve të para të jetës së fëmijës.

## 5.6 Cfarë është largimi (leja) e detyrueshme nga puna për shkak shtatëzanie?

*Ligji parashikon periudha gjatë të cilave është e ndaluar që gruaja shtatzënë të punojë (**leje e detyrueshme**):*



- Gjatë dy muajve përpara datës së parashikuar për lindjen;
- Për përiudhën gjatë datës së parashikuar për lindjen dhe datës efektive, nëse lindja ndodh pas datës së parashikuar;
- Gjatë 3 muajve pas lindjes;
- Pë ditët e papërdorura përpara lindjes, nëse ndodh përpara datës së paashikuar.

Punonjësja mund të zgjedhë të vazhdojë punën deri një muaj para datës së parashikuar për lindjen, e të përdorë kështu lejen e deyrueshme deri 4 muaj pas lindjes së fëmijës.
E gjithë kjo në rast se gjinekologu i Shërbimit Shëndetësor Kombëtar, o i konvencionuar, dhe mjeku përgjegjës për sigurinë në vendin e punës kur gruaja punon në ndërmarrje që është subjekt i kontrollove shëndetësore (psh. një ndërmarrje industriale), vërtetojnë se një situatë e tillë nuk shkakton pasoja negative për shëndetin e nënës e të fëmijës.

Gratë që kryejnë punë të rënda, të rrezikshme e që nuk mund të kryejnë detyra të tjera, të auorizuara nga Inspektoriati i Punës, mund të fillojnë lejen e barrës më herët se koha e parashikuar për arsye "rreziku".

Periudha e lejes së detyrueshme mund të shtyhet (me autorizim të Inspektoriatit të Punës) deri në muajin e 7 pas lindjes.



[3] Eshtë e rëndësishme të kujtohet se edhe gruaja jo komunitare me gëndrim jo të rregullt në territorin italian ka drejtë të shfrytëzojë falas disa shërbime spitalone të shërbimit shëndetësor kombëtar (shih kap. n. 4 Shëndeti dhe Asistenza Mjekësore).



Kompensimi për leje të detyrueshme për 3 muajt që pasojnë lindjen i takojnë **babait në marëdhënie pune**:

- Në rast vdekje apo sëmundje të rëndë të nënës;
- Në rastet kur nëna, qoftë edhe e papunë, braktis fëmijën;
- Ose në rastet kur nëna nuk njeh fëmijën.

Në këtë rast, është i ndaluar pushimi nga puna i babit të fëmijës deri sa ky i fundit të ketë mbushur 1 vjec.

Punonjësja ka të drejtën e kompensimit për lejen e detyrueshme për tre muajt që pasojnë lindjen edhe në rastet kur:

- Fëmija lind i vdekur;
- Fëmija vdes pas lindjes;
- Barra ndërpritet pas ditës së 180 të saj (që konsiderohet lindje).

### Ku paraqitet kërkesa për lejen e detyrueshme?

Pranë zyrës së INPS-it dhe punëdhënësit.



## 5.7 Cfarë është leja (largimi) fakultative e barrës?

*Gjatë 8 viteve të parë të jetës së fëmijës, të dy prindërit kanë të drejtë të marrin leje nga puna e njëkohësisht edhe kompensim për leje fakultative (shprehur ndryshe **leje familjare**).*

Mungesat fakultative nga ana e të dy prindërve nuk mund të jenë më tepër se:

- 6 muaj gjatë 3 viteve të para të jetës së fëmijë,
- 10 muaj gjatë 8 viteve të para të jetës së fëmijës.

### Kush mund të kërkojë leje fakultative?

- Nënat në marëdhënie pune për një periudhë të vazhdueshme o të ndërprerë për jo më shumë se 6 muaj;
- Baboi në marëdhënie pune për një periudhë të vazhdueshme o të ndërprerë për jo më shumë se 6 muaj, që mund të shtyhet deri në 7 në rast se babai largohet nga puna për një kohë jo më pak se 3 muaj (në këtë rast, koha e përgjithëshme e largimit nga puna të të dy prindërve, gjatë 8 viteve të parë të





jetës së fëmijës, shkon deri në 11 muaj);

- Prindit të vetëm (babait ose nënës) për një kohë të vazhdueshme apo me ndërpreprje, deri në jo më shumë se 10 muaj;
- Punonjëset e pavarura (kultivatorë, ndihmës e sezonale, artizanet e tregtaret), për një periudhë maksimale prej 3 muajsh, qoftë edhe me ndërprerje, brenda vitit të parë të jetës së fëmijës.

**Nuk** i takon atyre që shërbejnë pranë familjeve, atyre që punojnë në shtëpi, të papunëve apo atyre të pëzulluar nga puna.

Prindërit mund të përdorin lejen familjare edhe në të njëjtën kohë.

### Ku paraqitet kërkesa për lejen fakultative?

Pranë zyrës së INPS-it dhe punëdhënësit.

## 5.8 Cfarë janë pushimet ditore orare për të asistuar fëmijët?

*Gjatë vitit të parë të jetës së fëmijës nëna ka të drejtë për **pushime ditore** të paguara. Këto pushime janë 2 orë në ditë nëse orari ditor i punës është nga 6 orë e më sipër. Nesë orari i punës është më pak se 6 orë në ditë, parashikohet 1 orë leje në ditë.*

Këto orë pushimi i njihen edhe babait  në rast se:

- Fëmija i është besuar vetëm babait;
- Nëna vdes apo është e sëmurë rëndë;
- Në vend të nënës që është në marëdhënie pune e që nuk merr leje;
- Nëse nëna punon e pavarur.

Në këto rastet e fundit, babai gjithsesi nuk mund të përdorë pushimet ditore gjatë kohës së lejes së lindjes përdorur nga nëna.

**Nuk** i takon atyre që shërbejnë pranë familjeve, atyre që punojnë në shtëpi, të papunëve apo atyre të pëzulluar nga puna.

### Ku paraqitet kërkesa për pushimet ditore?

Për nënën, punëdhënësit.
Për babain, INPS-it dhe punëdhënësit.



## 5.9 A lejohet largimi nga puna në rast sëmundje të fëmijës?

*Të dy prindërit në marëdhënie pune kanë të drejtë të largohen, në mënyrë të alternuar, nga puna në rast sëmundje të fëmijëve:*



- Deri në moshën 3 vjec;
- Dhe deri ë 5 ditë në vit për secilin prind, deri në moshën 8 vjecare të fëmijës.

### Ku paraqitet kërkesa për leje për shkak sëmundje të fëmijës?

Kërkesa i duhet paraqitur punëdhënësit duke i bashkëngjitur certifikatën e një mjeku specialist të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar, e që duhet të tregojë që prindi tjetër nuk ka marrë leje në të njëjtët periudhë.

## 5.10 Cfarë është ceku i shtatëzanisë?

*Është një shërbim ekonomik për fëmijët e lindur apo birësuar nga 1 Korriku 2000 që i takon:*



- Grave që punojnë e që kanë paguar kontributet për të paktën për 3 muaj, duke përfshirë 9-18 muaj para lindjes së fëmijës apo hyrjes në familje të fëmijës së birësuar;
- Grave të papuna, vetëm nqs nga data e humbjes së të drejtës për shërbimet previdenciale dhe datës së lindjes së fëmijës nuk kanë kaluar më shumë se 9 muaj;
- Grave që punojnë dhe që kanë ndërprerë marëdhëniet punës duke dhënë dorëheqjen gjatë përiudhës së shtatëzanisë, dhe që grave që punojnë.

Nënat extrakomuniare duhet të kenë **kartën e qëndrimit** për të pasur mundësinë e cekut të shtatëzanisë.



### Ku paraqitet kërkesa për cekun e shtatëzanisë?

INPS-it brenda 6 muajve nga lindja apo birësimi i fëmijës (në rast se ky afat nuk respektohet, atëherë humbet e drejta për cekun e shtatëzanisë).

## 5.11 Cfarë është ceku i shtatëzanisë dhënë nga Komuna?

*Eshtë një ndihmë ekonomike dhënë cdo fëmije (në rast binjakësh, jepen 2 ceqe) të lindur apo birësuar pas 2 korrikut 2000 që i takon:*

- Nënave që nuk kanë të drejtë për asnjë lloj kompensimi shtatëzanie (në rats se kompensimi që marrin është më i ulët se vlera e cekut, atëherë njihet e drejta për të marrë diferencën);
- Grave që jetojnë në një familje të ardhurat e të cilës nuk janë më të larta se kuotat e përcaktuara (për cekun i lëshuar nga Komunat duhen paraqitur dokumentat I.S.E. – Indikatori i Situatës Ekonomike).

Nënat extrakomuniare duhet të kenë **kartën e qëndrimit** për të pasur mundësinë e cekut të shtatëzanisë.



### Ku paraqitet kërkesa për cekun e shtatëzanisë dhënë nga Komuna?

Komunës së rezidencës.

## 5.12 Cilët janë shërbimet kryesore në mbrojtje të pleqërisë?



- Pension pleqërie;
- Pension vjetërsie;
- Ceku social;
- Ceku për të mbijetuarit.

### Kur merret pensioni i pleqërisë?

Merret kur mbushet mosha, që aktialisht është 65 vjec për burrat e 60 për gratë, dhe kur janë derdhur kontributet për të paktën 20 vjet.
Duhet gjithashtu të jenë ndërprerë marëdhëniet e punës me kontratë.

### Kur merret pensioni i vjetërsisë[4]?

Mund të merret para mbushjes së moshës për pension.

[4] Sektori i pensioneve është në lëvije të vazhdueshme. Kufijtë e moshs për pension së shpejti do të pësojnë ndryshime.







Për **punonjësit me kontratë** kërkesat aktuale për marrjen e këij lloj pensioni është 35 vjet kontribute e 57 vjet mosha.
Nëse nuk është mbushur akoma mosha 57 vjec, munden sidoqoftë të merret ky lloj pensioni nëse janë bërë 37 vjet kontribute.
Eshtë e nevojshme që marëdhënia e punës të jetë ndërprerë.

Për **punonjësit e pavarur** (artizanët, tregtarët, kultivatorët, ndihmësit e sezonalët) kërkesa është 35 vjet kontribute e 58 vjet mosha. Nëse nuk është mbushur akoma mosha 58 vjec, munden sidoqoftë të merret ky lloj pensioni nëse janë bërë 40 vjet kontribute.
Punonjësit e pavarur mund të vazhdojnë aktivitetin e tyre.

## Cfarë është Ceku Social?

Eshtë një ndihmesë ekonomike për ata që kanë mbushur moshën 65 vjec, që banojnë rregullisht në Itali, nëse nuk kanë asnjë të ardhur tjetër ose nëse të ardhurat janë më të vogla se vlera e cekut.

Qytetarët jo komunitarë, duhet të kenë **kartën e qëndrimit** për të marrë cekun social.

Rezidenca e rregullt në Itali është një kusht bazë. Kush transferon rezidencën e tij jashtë Italisë, humbet të drejtën e cekut.



## Cfarë ndodh në rast vdekje të punonjësit të siguruar ose në pension?

Ekziston **pensioni për të mbijetuarit** (ose pasardhësit) që i takon anëtarëve të familjes së punonjësit të siguruar apo në pension, pas vdekjes së tij.

Ky pension mund të jetë i transferueshëm, nesë i vdekuri kishte një pension (pleqërie, vjetërsie apo invaliditeti), ose indirekt nëse personi, në momentin e vdekjes, ishte në marëdhënie pune.
Në këtë rast i vdekuri duhej të kishte akumuluar në cfarëdo kohe të paktën 15 vjet kontribute ose duhej të ishte i siguruar prej të paktën 5 vjetësh, prej të cilëve, të paktën 3 të derdhur gjatë 5 vjetësh para vdekjes.



## Cfarë të drejtash ka punonjësi jo komunitar që kthehet përfundimisht në vendin e tij të origjinës?

Qytetarët jo komunitarë që kthehen përfundimisht në vendin e tyre, ruajnë të drejtat previdenciale të maturuara.



Ma mbushjen e moshë 65 vjecare, mund të kërkojnë likujdimin e maturuar edhe nëse periudha e punës në Itali nuk është e mjaftueshme për një pension normal.

Ashtu si për shërbimet e tjera, edhe për këtë duhet paraqitur kërkesa.
Kërkesa mund të paraqitet prane Konsullatave Italiane si dhe të dërgohet me postë zyrës së INPS-it në Itali.
Tërheqja mund të kryhet në vendin e rezidencës.
Me disa vende[4] Italia ka stipuluar marrëveshje dypalëshe në lidhje me sigurimet shoqërore. Në këto rastë munsd të aplikoen rregulla të vecanta.

## 5.13 Cilat janë shërbimet previdenciale në rast invaliditeti fizik ose mendor të punonjësit?

- Ceku i zakonshëm i invaliditetit;
- Pensioni i invaliditetit;
- Pensioni për invalidët civilë.



### Cfarë është ceku i zakonshëm i invaliditetit?

Eshtë një cek që i takon punonjësve me kontratë e të pavarur, të prekur nga invaliditeti fizik o mendor, i vërtetuar nga mjekët e INPS-it, që kanë paguar 5 vjet kontribute (260 kontribute javore), prej të cilëve të paktën 3 vjet (156 javë) derdhur gjatë 5 vjetëve përpara datës së paraqitjes së kërkesës për cekun e zakonshëm të invaliditetit.

[5] Argjentinë, Australi, Bosnie, Herzegovinë, Brazil, Kanada – Quebec, Città del Vaticano, Kroaci, Jersey dhe Ishujt e Kanalit, Maqedoni, Principata e Monakos, Republika e KapoVerde, Republika e San Marinos, Republika Federale e Jugosllavisë, Slloveni, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Tunizi, Turqi, Uruguaj, Venezuelë.

Marrëveshja italo-jugosllave e 1957 mbetet përkohëshit në fuqi me Republikat e Kroacisë, Sllovenisë, Bosnies dhe Hercegovinës, Maqedonisë dhe me Republikën Federale të Jugosllavisë (përfshirë Kosovën), edhe pas shpalljes së pavarësisë së këtyre shteteve.

**Janë ende në fazë ratifikimi marrëveshjet me:** Kroaci dhe Città del Vaticano, Kili, Filipinet, Marokun dhe Republiën Ceke.
**Janë në fazë negocimi marrëveshjet me**:Korenë e Jugut, Zelandën e Re, Poloninë, Rumaninë dhe Sllovakinë.

Për informacione mbi listën e vendeve që kanë nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare me Italinë dhe mbi përmbajtjen e këture marrëveshjeve mund të shfletoni faqen në internet **www.inps.it/informazioni/panoramainternazionale/**, e mundur edhe në anglisht e frëngjisht.

### Cfarë është pensioni i invaliditetit?

Eshtë një pënsion që i takon punonjësve me kontratë e të pavarur, të prekur nga invaliditeti fizik o mendor, i vërtetuar nga mjekët e INPS-it, që bën të pamundur kryerjen e cfarëdolloj pune, e që kanë paguar 5 vjet kontribute (260 kontribute javore), prej të cilëve të paktën 3 vjet (156 javë) derdhur gjatë 5 vjetëve përpara datës së paraqitjes së kërkesës për pensionin e invaliditetit.

Kush bën kërkesë për këtë lloj pensioni **nuk mund:**

- Të hyjë në marëdhënie pune;
- Të regjistrohen në ndonjë albo profesionale;
- Të regjistrohet në listat e pinëtorëve të bujqësisë ose të pavarur (artizanë, tregtarë kultivatorët, ndihmësit e sezonalët).

### Cfarë është pensioni për invalidët civilë?

Eshtë një ndihmë ekonomike me natyrë asistenciale që INPS i siguron invalidëve civilë, të verbërve, shurdh-memecëve, që nuk kanë të ardhura personale, ose nëse po, janë shumë të ulëta.

## 5.14 Cfarë shërbimesh parashikohen për punonjësin që pushohet nga puna e që gjendet kështu i papunë?

*Asikuracionet kryesore për papunësinë që parashikohen nga sistemi ynë previdencial janë:*

- Kompensim i zakonshëm për papunësinë;
- Kompensim i zakonshëm për papunësinë me kërkesa të kufizuara;
- Kompensim i zakonshëm për punëtorët e bujqësisë;
- Trajtime të vecanta papunësie për punëtorët e bujqësisë;
- Trajtime të vecanta papunësie për punëtorët e ndërtimit.

## 5.15 Cfarë është kompensimi i zakonshëm për papunësinë?

*Eshtë një kompensim që u takon punonjësve të* ***pushuar*** *që:*

- Kanë të paktën 2 vjet asikuracion për papunësi të pavullnetëshme;
- Kanë të paktën 52 kontribute javore gjatë 2 vjetëve përpara datës së ndër-



prerjes së marëdhënieve të punës;
- Rezultojnë të papunë;
- Kanë deklaruar pranë zyrës së punës së zonës, disponibilitet.

**Nuk** i takon atyre që largohen me dëshirën e tyre, vecse në rastet e largimit për arsye të drejta (mungesa në pagesën mujore, ngacmime seksuale dhe ndryshim të detyrave) ose për shkak shtatzanie.

**Nuk** i takon punëtorit jo komunitar që ka leje qëndrimi për punë sezonale.

### Kur dhe për sa kohë paguhet pensioni i zakonshëm i papunësisë?

Kompensimi për papunësinë paguhen për muaj nga INPS dhe zgjat për 6 muaj (180 ditë).
Zgjat deri në 9 muaj (270 ditë) nëse në ditët e ndërprerjes së marëdhënieve punonjësi kishte një moshë 50 o më shumë vjec.

Pagimi pezullohet kur punonjësi:

- Ka marrë të gjitha ditët e kompensimit;
- Ka nisur nja aktivitet të ri pune;
- Fiton një trajtim pensioni të drejtpërdrejtë (pension pleqërie, vjetërsie, invaliditeti e paaftësie).



### Kujt dhe kur duhet të drejtoheni për të marrë kompensimin për papunësi të zakonëshme?

Menjëherë pas pushimit nga puna, duhet t'i drejtoheni zyrës së Punës e të deklaroni gjëndjen tuaj si të papunë dhe disponibilitetin tuaj të menjëhershëm.

Kërkesa për papunësi të zakonëshme i duhet paraqitur INPS-it (edhe me postë ose përmes Patronatit të autorizuar që, me ligj, ofron asistencë falas) brenda një kohe sa më të shkurtër, e sidoqftë, jo me tej se 68 ditë nga data e pushimit nga puna.
Kërkesës i duhet bashkangjitur një autocertifikim mbi statusin e papunënsisë e prej të cilit të rezultojë deklarata e disponibilitetit e paraqitur pranë zyrës së punës.



## 5.16 Cfarë është kompensimi i zakonshëm i papunësisë me kërkesa të kufizuara?

*Eshtë një kompensim që i takon punonjësit me kontratë që nuk plotëson kërkesat për marrjen e kompensimit për papunësi të zakonëshme, por që:*

- Ka punuar për të paktën 78 ditë gjatë vitit djellor paraardhës;
- Dhe rezulton të ketë të paktën një kontribut javor asikuraicioni për papunësi të pavullnetëshme përpara dyvjecarit djellor në fjalë (dyvjecari i është llogaritur duke u nisur nga dita e fundit e vitit djellor për të cilin kërkohet kompensimi).

**Nuk** i takon punëtorit jo komunitar që ka leje qëndrimi për **punë sezonale**.

### Kujt dhe kur paraqitet kërkesa për kompensim papunësi me kërkesa të kufizuara?

Agjencisë së INPS-it të zonës përkatëse, nga data 1 Janar deri në datë 31 mars të vitit pas atij të cilit i referohet kompensimi.

5

## 5.17 Cfarë është kompensimi i zakonshëm për papunësinë për punëtorët e bujqësisë?



*Eshtë një kompensim që i takon:*

- punëtorëve të regjistruar në listat e punëtorëve të bujqësisë;
- atyre që kanë punuar si punëtore bujqësie me kontratë pa afat për një pjesë të vitit;

që janë **pushuar,** nëse:

- janë regjistruar në listat emërore të punëtorëve të bujqësisë gjatë vitit djellor për të cilin kërkohet kompensimi (kusht që nuk aplikohet për punëtorët me kontratë pa afat);
- kanë të paktën 2 vjet asikuracion kundër papunësisë së pavullnetëshme;
- kanë të paktën 102 kontribute ditore gjatë dyvjecarit përpara paraqitjes së kërkesës (në mungesë të 102 kontributeve, kompensimi takon sërish nëse punëtori ka kryer, gjatë vitit kur kryen kërkesën, punë me kontratë për të paktën 78 ditë).

**Nuk** i njihet atyre qe largohen me dëshirë nga puna, me përjashtim të grave shtatzëna, dhe kur dorëheqja vjen për shkaqe të drejta (mungesa në pagesën mujore, ngacmime seksuale dhe ndryshim të detyrave).

### Kujt dhe kur paraqitet kërkesa për kompensim papunësie për punëtorët e bujqësisë?

Kërkesa i paraqitet zyrs së INPS-it përkatëse brenda 31 marsit të vitit që pason atë të cilit i referohet kompensimi.

## 5.18 Cfarë janë trajtimet e vecanta për papunësinë për punëtorët e bujqësisë?

*Eshtë një trajtim i vecantë që i takon punonjësve të regjistruar në listat e punëtorëve të bujëqësisë, nqs:*

- janë regjistruar në listat emërore të punëtorëve të bujqësisë gjatë vitit djellor për të cilin kërkohet kompensimi (kusht që nuk aplikohet për punëtorët me kontratë pa afat);
- kanë të paktën 2 vjet asikuracion kundër papunësisë së pavullnetëshme;
- kanë të paktën 102 kontribute ditore gjatë dyvjecarit përpara paraqitjes së kërkesës (në mungesë të 102 kontributeve, kompensimi takon sërish nëse punëtori ka kryer, gjatë vitit kur kryen kërkesën, punë me kontratë për të paktën 78 ditë).
- Kanë punuar me kontratë afatshkurtër gjatë vitit të cilit i referohet kërkesa;
- Kanë punuar për të paktën 151 ditë si punëtorë me kontratë ose që rezultojnë të regjistruar, gjatë vitit të cilit i referohet kërkesa, në listat emërore të punëtorëve të bujqësisë pqr një numeër ditësh nga 101 në 150.

**Nuk** i njihet atyre qe largohen me dëshirë nga puna, por vetëm në rast **pushimi nga puna** (me përjashtim të grave shtatzëna)

### Kujt dhe kur paraqitet kërkesa për kompensim të vecantë papunësie për punëtorët e bujqësisë?

Kërkesa i paraqitet zyrs së INPS-it përkatëse brenda 31 marsit të vitit që pason atë të cilit i referohet kompensimi.



## 5.19 Cfarë është trajtimi i vecantë për papunësinë për punëtorët e ndërtimit?

*Eshtë një shërbim për punëtorët e sektorit të ndërtimit që janë pushuar, kur verifikohen:*

- ndërprerja e aktivitetit të ndërmarrjes;
- përfundimi i kantierit apo i fazave të vecanta të punës;
- reduktimi i personelit;

nëse gjatë 2 viteve përpara datës së pushimit nga puna:

- kanë derdhur të paktën 10 kontribute mujore ose 43 kontribute javore në sektorin e ndërtimit;
- janë regjistruar në listat e të papunëve.

**Nuk** i njihet kujt jep dorëheqjen me dëshirë, por vetëm kush pushohet (me përjashtim të grave me leje lindje që trajtohen edhe në rast dorëheqjeje).



### Kujt dhe kur paraqitet kërkesa për trajtim të vecantë papunësie në sektorin e ndërtimit?

Kërkesa i paraqitet INPS-it kompetent brenda 2 vjetëve nga data e pushimit nga puna, duke ndjekur modelet që gjenden pranë zyrave të sipërpërmendura.



## 5.20 Cilët janë shërbimet në mbrojtje të familjes?

- Ceku për bërthamën familjare;
- Dhe ceku familjar.

## 5.21 Cfarë është ceku për bërthamën familjare?

*Eshtë një shërbim në ndihmë të familjve të:*



- punonësve me kontratë, atyre në  cassaintegrazione, të papunëve që marrin kompensimin për papunësinë apo mobiliteti;
- punëtorëve socialë;
- pensionistëve që kanë punuar me kontratë;

për bërthamat familjare që përbëhen nga persona të ardhurat e të cilëve janë nën nivelin e përcaktuar vit pas viti nga ligji.

Për punonjësin jo komunitar konsiderohen si bërthamë familjare vetëm familjarët rezidentë në Itali, me përjashtim të rasteve kur punonjësi vjen nga një shtet me të cilin janë nënshkruar marrëveshje o konvencione të vecanta.

**Nuk** i takon punonjësit jo komunitar që ka leje qëndrimi vetëm për punë sezonale.

### Ku bëhet kërkesa për cekun për bërthamën familjare?

- Kush kryen aktivitet nën kontratë jo të sektorit të bujqësisë duhet t'i paraqesë kërkesën **punëdhënësit**;
- Në të gjithë rastet e tjera (përfshirë shërbyesve pranë familjeve) kërkesa i paraqitet **INPS-it**.

5

## 5.22 Cfarë është ceku familjar?

*Eshtë një shërbim që i takon:*

- punonjësit të bujqësisë të pavarur (kultivatorët, ndihmësit e sezonalët);
- pensionistit që ka punuar në mënyrë të pavarur (artizan, tregtar, bujk, ndihmës e sezonal);

nëse familjarët për të cilët kërkohet ceku janë në ngarkim të tij;
dhe nëse bërthama familjare nuk kalon kufijtë e caktuara për të ardhurat vjetore.

### Kush konsiderohet familjar në ngarkim?

Familjarët që kanë të ardhura personale, të cfarëdo lloj natyre qofshin, që nuk kalojnë shumën mujore të përcaktuar vit për vit.
Ligji parashikon personat që mund të kërkojnë cekun familjar.

### Ku paraqitet kërkesa për cekun familjar?

INPS-it.

## 5.23 A është i detyruar punëdhënësi të mbrojë shëndetin e punonjësit?

*Punëdhënësi, qoftë edhe përmes një personi të deleguar prej tij (**Përgjegjësit për Sigurinë**), është i detyruar të:*

- informojë punonjësin për rreziqet që ka vendi i punës;
- informojë mbi detyrat dhe normat e sigurimit;
- sigurojë falas mjetet për mbrojtjen personale që punonjësi duhet të përdorë në bazë të detyrave që ka (këpucë kundër rrëshqitjes, doreza, kufje antizhurmë, etj...) me qëllim parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.



### Ku duhet të drejtoheni në raste parregullsie apo rreziku në vendin e punës?

Duhet t'i drejtoheni ASL-it që erogojnë shërbime parandalimi e sigurimi në ambjentet ku punohët.
Inspektorët e ASL-it kontrollojnë masat e sigurisë dhe sinjalizojnë shkeljet pranë Autoriteteve Gjygjësore.
Asl-et marrin edhe sinjalizimet për rastet e aksidenteve në punë.

Statuti i punonjësve parashikon edhe të drejtën e tyre, përmes përsonash të deleguar nga ata vetë, për të kontrolluar dhe promovuar praktikimin e normave për parandalimin e aksidenteve dhe semundjeve profesionale.



### Cfarë ndodh në rast aksidenti apo semundjeje profesionale?

Kushtetuta Italiane u garanton të gjithë qytetarëve të drejtën e shëndetit në vendin e punës dhe të drejtën për mjete të përshtatëshme me kërkesat e jetesës në rast aksidenti në punë apo semundje profesionale.

Ligji përcakton detyrimin asikurativ ndaj dëmeve fizike dhe ekonomike që punonjësi pëson për shkak aksidenti e semundje që vijnë prej aktivitetit të tij të punës.

**INAIL** - Instituti Nacional për Siguracionin ndaj Aksidenteve në punë e Sëmundjeve Profesionale – administron këtë asikuracion të detyrueshëm, dhe erogon shërbime për punonjësit e siguruar që pësojnë aksident apo sëmundje profesionale për shkak të aktivitetit të tyre të punës.

Në rastin kur punonjësi aksidentohet apo manifeston shenja semundje profesionale, punëdhënësi duhet të paguajë:

- të plotë ditën kur ka ndodhur aksidenti apo është shfaqur sëmundja profesinale, nëse kjo e fundit shkakton mungesën në punë;



- 60% të rrogës, përvecse në rast trajtimi ekonomik më të lartë se ai parashikuar nga kontrata e punës,  përgjatë 3 ditëve të largimit nga puna.

Ndërsa INAIL paguan:

nga dita e katërt pas aksidentit apo manifestimit të semundjes profesionale deri në shërimin e plotë klinik.

## Cfarë duhet të bëjë punonjësi në rast aksidenti gjatë punës[6]?

- Duhet të informojë menjëherë punëdhënësin;
- Paraqesë menjëherë punëdhënësit raportin mjekësor, dhe nëse kurat zgjasin, raporti mjekësor duhet plotësuar nga mjeku kurues.

Punëdhënësi duhet t'ë dërgojë pranë zyrave të INAIL origjinalet e raporteve.
Në rast shtrimi, spitali dërgon pranë zyravbe të INAIL dhe punëdhënësit kopje të certifikatave.

## Cfarë duhet të bëje punonjësi në rast semundje profesionale?

Nëse punonjësi është në marëdhënie pune, duhet të:

- Sinjalizojë sëmundjen punëdhënësit brenda 15 ditësh nga shfaqja e saj;
- Paraqesë punëdhënësit raportin mjekësor, dhe në rast vazhdimi të kurës, certifikatën e plotësuar nga mjeku kurues.

Punëdhënësi, nga ana e tij, i dërgon INAIL-it certifikatat në origjinal.
Në rast shtrimi, spitali dërgon pranë zyrave të INAIL dhe punëdhënësit kopje të certifikatave.

Nëse punonjësi **nuk** është në marëdhënie pune:

- **mund** të paraqesë direkt INAIL-it, kërkesën për njohjen e sëmundjes profesionale.





[6] Punonjësit jo në rregull, përfshirë ata që nuk janë në rregull me normat e hyrjes dhe qëndrimit në Itali, në rast aksidenti kanë të drejtë për asistencën shëndetësore falas në ambulancat apo spitalet publike e private të akredituara nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar (shih kapitullin n. 4. Shëndeti dhe Ndihma Mjekësore).

**Statuti i Punëtorëve ndalon diskriminimet bërë punonjësve në bazë gjinie, race, feje, mendimi politik.**
**Punonjësi mund t'i drejtohet Sindakatave për mbrojtjen e të drejtave të tij.**

Duke marrë parasysh kompleksitetin e sistemit previdencial, këshillohet t'i drejtoheni **Patronateve** për të pasur shërbimet e ofruara.
Ligji i beson këtyre të fundit detyrën për mbrojtjen dhe asistimin e punonjësve, në mënyrë plotësisht **falas**, gjatë të gjitha proceseve parandaluese e asistenciale.

*Më tej, për të pasur informacione më të detajuara mbi shërbimet, pensionin dhe kontributet mund të: shfletoni në internet adresat:*

**www.inps.it/informazioni/ • www.inail.it/Piemonte/**

*ose të telefoni Call Center*

**INPS: 164 64. • INAIL: 803888 (cdo ditë nga ora 8.00 në orën 18.00)**









# 6 familja



## 6.1 Kush mund të kërkojë bashkimin familjar[1]?

*Qytetari jo komunitar:*

- Me **Kartë qëndrimi**;
- Me **Leje qëndrimi** me afat jo më pak se 1 vit për motive punësimi (me kontratë apo i pavaruar), azil politik. Studim ose motive fetare.

### Më cilët familjarë ka të drejtë të bashkohet?

- Me bashkëshortin/en ligjërisht jo të ndarë;
- Me fëmijët e mitur (më pak se 18 vjec) në ngarkim, (qoftë edhe të bashkëshortit ose të lindur jashtë martese), e pamartuar (ose ligjërisht të ndarë, me kusht që prindi tjetër, nëse gjallë, të japë miratimin e tij (minorët e birësuar apo nën tutelë trajtohen si fëmijët);
- Me fëmijët në moshë madhore në ngarkim, që nuk mund, për arsye objektive, të sigurojnë për veten e tyre për shkak të shëndetit që con në invaliditet të plotë;
- Me prindërit në ngarkim nëse prindërit nuk kanë fëmijë të tjerë në vendin e prejardhjes apo të origjinës;
- Me prindërit më moshë mbi 65 vjec në rast se nuk kanë fëmijë të tjerë në vendin e prejardhjes apo të origjinës ose këta nuk kanë mundësi për kujdesin ndaj tyre për motive të rënda e të dokumentuara shëndetësore.



### Cfarë kërkesash janë të nevojshme për të kërkuar bashkimin e familjes?

I huaji (përvec në rastin e një refugjati) që kërkon bashkimin familjar duhet të tregojë mundësinë e:

- Një **banese të përshtatëshme** (që hyn në parametrat minimalë parashikuar nga ligji rajonal për banesat rezidenciale publike) dhe, që rast fëmije më të vogël se 14 vjec që vjen me një nga prindërit, miratimin e titullarit të banesës ku minoreni do të banojë;
- Një të **ardhure vjetore**, prej burimesh të ligjëshme jo më të ulët se:
  shuma vjetore e cekut social[2] nëse kërkohet bashkim me një familjar të vetëm;
  dyfishi i shumës vjetore të cekut social nëse kërkohet bashkim me dy ose tre familjarë;
  trefishi i shumës vjetore të cekut social nëse kërkohet bashkim me katër ose më shumë familjarë (për përcaktimin e të ardhurave merret parasysh edhe e ardhura vjetore e familjarëve që jetojnë me kërkuesin).





## Kujt i paraqitet kërkesa për bashkim familje?

Kërkesa për *nulla osta për bashkim familje,* bashkë me dokumentacionin e nevojshëm, paraqitet pranë **sportelit për imigracionin** pranë Prefekturës (Zyrës Territoriale të Qeverisë - - UTG)[3] të vendit ku banoni.
Sporteli lëshon një kopje të kërkesës të shënuar, vulosur e firmosur.

Pasi të ketë verifikuar përmbushjen e kërkesave, zyra merr masën e kërkuara (qoftë edhe të mohimit të nulla ostës)

90 ditë pas paraqitjes së kërkesës për nulla osta, është e mundur të merret viza e hyrjes drejt për së drejti nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullatat italiane, duke treguar një kopje të akteve të regjistruara nga sporteli për imigracionin pranë Prefekturës (Zyrës Territoriale të Qeverisë - - UTG), prej të cilëve rezulton data e paraqitjes se kërkesës e dokumentacionit të kërkuar.



## Cfarë dokumentesh shërbejnë për të kërkuar bashkimin familjar?

- Kërkesa për Nulla Osta në 2 kopje;
- Pullë €. 10.33;
- Leje ose kartë qendrimi (originali dhe fotokopjen);
- Dokument që vërteton mundësinë për një banesë të përshtatëshme për të pritur familjarët që mund të jetë:
  - Kontratë qeraje (jo kalimtare apo përdorim të rrallë);
  - Kontratë përdorimi **(kontratat duhet të jenë të regjistruara rregullisht)**;
  - një deklaratë mikpritjeje nga persona të tretë ose punëdhënësi, duke i bashkëngjitur aktin që mbështet këtë mundësi banese;
  
  Deklarata e mikpritjes mund të paraqitet me firmë të autentikuar dhe duhet të shprehë qartë miratimin për bashlimin me familjarët e përmendur, bashkë me saktësimin e sipërfaqes së banimit vënë në dispozicion (për bashkimin me fëmijë nën moshën 14 vjec, deklarata duhet të përmbajë aprovimin e pronar-it të banesës);
  - akti i shit-blerjes së banesës;



[1] Aspekti i bashkimi familjar është ndryshuar shumë me ligjin 189 të vitit 2002. Udhëzimet e reja do të aplikohen pas aprovimit te rregullores së praktimit.

[2] Për të ditur më shumë mbi Cekun Social, shih kap. 5. Puna.

[3] Shih adresat në fund të udhëzuesit.

• shënimi I traskrivimit të kontratës së qerasë ose shit-blerjes;

- certifikatë komunale që vërteton përshtatshmërinë e banesës (parametra të parashikuar nga ligji rajonal për banesat rezidenciale);
- certifikatë rezidence;
- dokumenta që tregojnë lidhjen familiare, e përkthyer dhe legalizuar nga ambasada italiane në vendin e origjinës së kërkuesit;
- dokumentat që tregojnë aktivitetin e punës dhe të ardhurat:

**a) Nëpunësi** duhet të paraqesë:

• Kontratën e punës, që duhet të specifikojë natyrën e aktivitetit, kohëzgjatjën dhe pagesën vjetore (kjo duhet të jetë e vërtetuar nga Zyra e Punës dhe deklarata e punëdhënësit duhet të ketë një firmë të autentikuar);

• Dokumentin e rrogës mujore, modelin 101 o 730 (ose cfarëdo deklarate të ardhurash);

• Librezën e punës dhe kodin fiskal;

• Dokumentacion tjetër integrativ në rast se e ardhura nga puna nuk është e mjaftueshme (të ardhurat e familjarëve të tjerë që bashkëjetojnë, deposita ose kursime).

**b) Punonjësi i pavarur** duhet të paraqesë:

• licenca, autorizime, regjistrime në urdhra të ndryshëm apo registra (certificata regjistrimi në Dhomës e Tregëtisë, Urdhërin e Artizanëve, akte themelimi shoqërish, etj.);

• modelin 740 dhe kodin fiskal;

• Dokumentacion tjetër integrativ në rast se të ardhurat nuk janë të mjaftueshme (të ardhurat e familjarëve të tjerë që bashkëjetojnë, deposita ose kursime).





## 6.2 Si paraqitet cështja kundër mohimit së nulla osta apo të vizës së hyrjes për bashkim familje?

**Autoriteti gjygjësor kompetent**.
Gjykata e shkallës së ulët me përbërje monokratike (T.C.M.) e vendit ku banon i interesuari[4].

**Afati për paraqitjen e cështjes**.
Asnjë afat i caktuar.
Cështja nuk është objekt i afateve të skadimit.

**Shpenzime gjygjësore**.
Përjashtuar.

**Informacione specifiche**.
Mbrojtja juridiksionale në këto raste i njihet titullarit të të drejtës për unitetin e familjes (dmth të huajit që kërkon bashkimin me familjarët e tij), që si rregull banon rregullisht në Itali.
Për këtë arsye cështja paraqitet në Itali, pranë Gjykatës së vendit ku banon i interesuari.
Nëse pranon cështjen, Gjykatësi mund të urdhërojë menjëherë lëshimin e vizës nga konsullata italiane.
Nëse cështja refuzohet, mund të paraqitet ankesa pranë Gjykatës së Apelit, brenda 10 ditësh nga data e dekterit të Gjykatësit.

**Për asistencë ligjore në ngarkim të Shtetit (falas)[5]**.

[4] Shih adresat në fund të udhëzuesit.

[5] Shih kapitullin 11 Tutela juridiksionale.

6







## 6.3 Si paraqitet cështja kundër masave të marra në lidhje me qëndrimin për motive familjare (lëshim, renovim dhe refuzim të lejes së qëndrimit për motive familjare)?

**Autoriteti gjygjësor kompetent**.
Gjykata e shkallës së ulët me përbërje monokratike (T.C.M.) e vendit ku banon i interesuari.[6]

**Afati për paraqitjen e cështjes**.
Asnjë afat i caktuar.

**Shpenzime gjygjësore**.
Përjashtuar.

**Për asistencë ligjore në ngarkim të Shttit (falas)**[7].

## 6.4 Cfarë kërkesash duhen përmbushur për t'u martuar në Itali?

*Mund të martohet qytetari (i huaj a italian) që:*

- Ka mbushur 18 vjec (në Itali përfaqëson moshën madhore); mund të martohet kush ka mbushur 16 vjec, vetëm me autorizimin e Gjykatës për Minorenët;
- Është i lirë nga detyrimet bashkëshortore.
  Ligji italian ndalon martesën mes personash të martuar (bigaminë).



### Kujt duhet t'i drejtoheni në rast martese?

Zyrës së Gjendjes Civile të Komunës së rezidencës, që siguron **publikimet e martesës.** Këto bëjnë publike vullnetin e personave për t'u martuar dhe janë të parashikuara nga ligji italian.
Publikimet bëhen edhe në Komunën e rezidencës së bashkëshortit tjetër.
Akti i publikimit i kërkohet punonjësit të Gjendjes Civile dhe firmoset në prezencë të dy dëshmimtarëve.
Akti i publikimit qëndron i afishuar për 8 ditë dhe vlen për 180 ditë.
Martesa mund të celebrohet duke nisur nga dita e katërt pas datës së skadimit të publikimit.

Nëse një nga bashkëshortët nuk njeh italishten, punonjësi i Gjendjes Civile mund të celebrojë me prezencën e një përkthyesi.





### Cilët janë dokumentet e nevojshme?

- Pashaportë e vlefshme ose karta e identitetit.
- **Nuk** është e nevojshme të paraqitet leja e qëndrimit, që megjithatë kërkohet me deyrim në rast se mungojnë dokumente të tjera identifikimi.
- Deklaratë e lëshuar nga Autoritetet konsullore të Vendit të origjinës së qytetarit/res së huaj nga e cila të rezultojë se në bazë të ligjeve lokale nuk ka asgjë që të kundërshtojë martesën (deklaratë nulla osta).
  Nëse Autoriteti diplomatik konsullor nuk përgjigjet ose transmeton një deklaratë refuzimi të motivuar, punonjësi i Gjendjes Civile duhet të refuzojë publikimet.
  Cështja në Gjykatën Civile pranohet nëse refuzimi i nulla osta vjen si shkak i dispozicioneve të ligjit të huaj që bien ndesh me parimet e urdhëresave publike italiane.
  Në rast **qytetari të huaj me status refugjati politik**, në vend të Nulla Osta duhet paraqitur një deklaratë e lëshuar nga Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara me qendër në Romë.

### Cila është procedura për martesat religjoze me vlerë civile?

Kërkohen publikimet ministrit të kultit.

Besimtarët e mëposhtëm mund të kërkojnë publikimet direkt zyrave të gjendjes civile:
Kisha Valdeze, Komuniteti Izraelitik, Kisha Adventiste e Ditës së Shtatë, Asambleja e Perëndisë në Itali, Bashkësia e Kishave Ungjëllore Valdeze Italiane, Kisha Ungjëllore Luterane italiane

Martesat ekskluzivisht religjoze (ato të celebruara nga ministra kulti të papranuar nga Shteti italian), nuk kanë vlerë civile.

### A mund të njihet jashtë martesa e lidhur në Itali?

Një qytetar i huaj që martohet me ritin civil në Itali, duhet gjithmonë të kontrollojë nëse ligji i vendit të tij të origjinës e njeh një martesë të tillë, dhe për rrjedhojë të

[6] Shih adresat në fund të udhëzuesit.

[7] Shih kapitullin 11 Tutela juridiksionale.

njohë cfarë procedurash duhet të nisë për të konvertuar aktin e martesës (dmth njohjen jashtë).

Martesat e lidhura përpara autoriteve diplomatike o konsullore të huaja mund të konvertohen në Itali me kusht që kjo të jetë e përfshirë nga Konvencionet në fuqi lidhur me cështjen, me këto vende.

Eshtë i mundur konvertimi i martesës së lidhur me ritin musulman mes një qytetari italian dhe një qytetari të huaj i fesë islame.

Për konvertimin e aktit duhet paraqitur dhe përkthimi në gjuhën italiane, dhe legalizimi i këtij akti.
Konvertimi pranohet në rast se përmbajtja nuk bie ndesh me urdhërin publik italian.



## 6.5 Ku duhet të lajmërohet për lindjen e një fëmije[8]?

*Për fëmijët që lindin në Itali duhet të lajmërohen:*

- **Zyra e Gjendjes Civile të Komunës** ku ka nodhur lindja;
- **Drejtoria e Shëndetit e Spitalit apo Klinikës**, që lajmëron Zyrën e Gjendjes Civile së Komunës ku lind fëmija.

### Kush mund të lajmërojë për lindjen e fëmijës?

Një nga dy prindërit, një prokurator i vecantë, një mjek, mami' o kushdo tjetër që ka asistuar gjatë lindjes.

### Cfarë dokumentash janë të nevojshme për regjistrimin?

- Dokument identiteti të njërit prej prindërve (ose të të dyve nëse nuk janë të martuar);
- Certifikata e lindjes lëshuar nga Spitali (në rast regjistrimi direkt në Zyrën e Gjendjes Civile).

**Nuk është e nevojshme të paraqitet leja e qëndrimit.**





Nëse prindërit kanë leje qëndrimi dhe janë rezidentë në Itali, certificata e lindjes i dërgohet për konvertim Komunës së rezidencës së familjes.

### Brenda cfarë afati regjistrohet linda e fëmijës?

- brenda **10 ditësh** nga linda pranë punonjësit të gjendjes civile të komunës ku lind fëmija (nga njëri prej prindërve);
- brenda **3 ditësh** nga lindja pranë Drejtorisë Shëndetësore të spitalit apo klinikës.

Njohja e fëmijës është e mundur edhe para lindjes së tij.
Në këtë rast është e nevojshme që pranë zyrës së Gjendjes Civile të paraqitet certifika mjekësore e lëshuar nga mjeku kurues apo Kompania Shëndetësore Lokale (A.S.L.) që vërteton shtatëzaninë dhe ditën e parashuikuar për lindjen.

### Cfarë emrash mund t'i vihen fëmijës?

Eshtë e ndaluar që fëmijës t'i jepet emri i babait të gjallë, i një vëllai apo motre dhe emra qesharakë, të turpshëm e në kundështim me rendin public.

Njoftmi për **fëmijët natyralë** (të lindur jashtë martese) ndodh me të njëjtat modalitete që parashikohen për **fëmijët e ligjshëm** (të lindur gjatë martesës)

### A është e mundur të konvertohen certifikatat e lindjes prej vendeve të tjera?

Po, mund të konvertohen, me kërkesë të prindërve rezidentë në Itali.
Aktet duhet të përkthehen në gjuhën italiane dhe legalizuar nga autoriteti i huaj kompetent.
Për këtë, duhet t'i drejtoheni Zyrës se Certifikatave të Lindjes të komunës së rezidencës.

[8] Vini re' që në Itali është e mundur mosnjohja e fëmijës në lindjen e tij. Shih kap. 4. Shëndteti dhë Asistenca Mjekësore.





# 7 minorenët e pashoqëruar

## 7.1 Kush janë minorenët e huaj të pashoqëruar?

*Janë minorenët jo komunitarë (që nuk kanë nënshtetësinë italiane ose të një vendi të Bashkimit Europian) që gjenden në Itali pa asistencë dhe përfaqësi nga ana e prindërve o të rritur të tjerë ligjërisht përgjegjës në bazë të legjislacionit italian në fuqi, dhe që nuk kane paraqitur kërkesë për strehim.*



Konsiderohen pa përfaqësi ligjore[1] edhe ata minorë besuar personave të rritur (përfshi të afërm deri në brezin e 4) që nuk janë tutorët apo kujdestarët në bazë të një urdhëri formal.

### Kujt i duhet sinjalizuar presenza e një minori të huaj?

Cdo minoren i huaj i pa shoqëruar duhet të sinjalizohet pranë Prefekturës (Zyrës territoriale të Qeverisë - U.T.G.), që transmeton senjalizimin **Komitetit për minorët e huaj**, që vendos nëse minoreni duhet të kthehet në vendin e tij apo të qëndrojë në Itali.

### Cfarë bën Komiteti për minorët e huaj?



Menjëherë pas marrjes së sinjalizimit për prezencën e një minori të pashoqëruar, Komiteti për minorët e huaj përcakton brenda 60 ditëve hetimet për të gjetur familjen e minorenit, në vendin e origjinës ose vende të tjera, për të verifikuar disponibilitetin e autoriteteve të vendit të origjinës për të marrë përsipër kujdestarinë dhe kthimin në vend.

Me **"kthimin e asistuar"** garantohet asistenca e duhur deri në takimin me familjarët apo dorëzimin pranë autoriteteve përkatëse në vendin e origjinës.

Kundër vendimit që imponon kthimin në atdhe, minoreni mund të paraqesë ankesën e tij, ndihmuar nga tutori apo prindërit (që mund t'i lëshojnë prokurë një avokati përmes konsullatës italiane në vendin e origjinës), pranë Gjykatës së zakonëshme[2].

Në pritje të vendimit të Komitetit, minorit i jepet leje qëndrimi **"për moshë të mitur"**.

Minori duhet të jetë i sinjalizuar edhe pranë gjykatësit tutelor apo Gjykatës për minorenët[3], me qëllim që të caktohet përsoni ligjërisht përgjegjës (**tutori**)për minorin, dhe me qëllim përcaktimin e një kujdestari të mundëshme.
Masat që merren në tutelë të minorit duhet të aplikohen edhe pse Komiteti për minorët e huaj nuk ka ndërhyrë ende.





Sinjalizimi mund të kryhet përmes Zyrës për Minorët e huaj të Komunës (aty ku ekziston) ose Shërbimeve Sociale kompetente në bazë të vendit të banimit.

Me mbushjen e moshës 18 vjec, mund të lëshohet një leje qëndrimi për motive studimi, pune, punë me kontratë ose të pavarur, edhe pse nuk ka ende një vendim të Komitetit për Minorenët e huaj nëse:
Gjykatësi apo Gjykata për minorenët kanë vendosur kujdestarinë e minorenit prej një prej familjarëve, komuniteti ose një familjeje, ose nëse është caktuar tutori;

dmth nëse plotësohen kushtet e meëposhtëme:

- Minoreni duhet të ketë hyrë prej të paktën 3 vjetësh kur të mbushë moshën 18 vjec, dmth të ketë qenë 15 vjec kur ka hyrë në Itali;
- Të jetë regjistruar në një projekt integrimi social dhe civil të një enti public ose privat që të ketë përfaqësi në territor dhe që është në listat e enteve të njohura për aktivitete në të mirë të minorëve të huaj prej të paktën 2 vjetësh;
- Të ketë mundësinë e një banese, kurse studimi të vazhdueshëm, ose që punon me pagesë, dmth ka një kontratë pune edhe pse nuk ka filluar ende të punojë.

Lëshohet **leja e qëndrimit për kujdestari** (i renovushëm me mbushjen e 18 vjetëve), kur Komiteti për të Minorët e huaj merr vendim për kthimin në atdhe të minorenit, dhe Gjykatësi tutelor ose Gjykata për minorenët merr vendim për lënien në kujdestari të minorit.

Sidoqoftë, konvertimi i lejes së qëndrimit në moshë madhore nuk është automatike, por vlerësohen: kohëzgjatja e qëndrimit në Itali, sjellja, shkalla e integrimit, mundësia për të gjetur punë dhe ndjekja e studimeve, ej.

Jashtë këtyre hipotezave, leja e qëndrimit me mbushjen e moshës 18 vjec **nuk** mund të konvertohet në leje qëndrimi për punë apo studim, me pasojë që i riu, edhe pse punon ose studion, kthehet në klandestin i përjashtueshëm.





[1] Përfaqësimi ligjor i një minoreni ushtrohet nga prindi apo tutori. Një i afërm tjetër që nuk është emëruar tutor nuk ka të drejtë të përfaqësojë ligjërisht minorin.

[2/3] Shih adresat në fund të udhëzuesit.

**Cilat janë të drejtat që i garantohen minorit të huaj të pashoqëruar?**

Minorit të huaj të pashoqëruar i garantohen të drejtat lidhur me qëndrimin e përkohëshëm, shërbimeve mjekësore, shkollimin.











# 8 shkolla



## 8.1 Ku mund të cohen fëmijët e moshës nga 3 muaj në 3 vjec?

*Mundësitë janë shumë të diferencuara:*

- **Cerdhe komunale ose private:**
  fëmijë nga 3 deri 36 muaj, praninë e shërbimit të mensës,
  qëndrimin e fëmijës gjatë gjithë ditës, në funksion të orareve të cerdhes;
- **baby parking**:
  fëmijë të moshë 13 muaj deri në 6 vjec (në disa qëndra pranohen edhe fëmijë latantë), mungesa e shërbimit të mensës,
  qëndrimin e fëmijës për jo më tepër se 5 ore të vazhdueshme në ditë;
- **shërbimet edukative integrative:**
  ofrohen hapësira loje e takimi për fëmijë të shoqëruar nga të rritur.

Për të pasur informacione më të detajuara mbi shërbimet, mund t'i drejtoheni Komunës suaj të rezidencës.

## 8.2 Ku shkojnë në kopësht fëmijët e moshës nga 3 në 5 vjec?

*Në **Kopështin e fëmijëve më të afërt me banesën tuaj.** Këtu prindërit mund të kenë informacione në lidhje me regjistrimin në kopësht dhe orarin. Kopështet e fëmijëve mund të jenë shtetërorë, bashkiakë, paritar, private.*



### Kur duhet bërë regjistrimi?

Kërkesa për regjistrim paraqiten në muajin janar të vitit shollor pasues.
Nëse ka vende të lira në kopësht, regjistrimi mund të bëhet edhe gjatë vitit shkollor.

### Cfarë dokumentash shërbejnë për regjistrimin?

Nuk kërkohen dokumenta për frekuentimin e kopështit.
Informacionet mbi fëmijën jepen nga prindi me përgjegjësinë e plotë të këtij të fundit.

### A është e mundur ngrënia në kopësht?

Po. Në kopështet që punojnë me orar të plotë, paradite e pasdite, me drekën në kopësht, është e nevojshme të paguhet kuota për mensën që përcaktohet në bazë të të ardhurave të familjes.
Për këtë duhet pasur kodi fiskal dhe duhen paraqitur dokumenta mbi të ardhurate e familjes.

Në mensë mund të kërkohen menu të diferencuara për motive shëndeti (kërkohet deklarata e mjekut) dhe për motive fetare.

## 8.3 Në cilën shkollë shkojnë fëmijët e moshës nga 6 në 10 vjec?

*Në **Shkollën fillore më të afërt me banesën**.*
*Këtu mund të merren infromacione mbi regjistrimin ne shkollë dhe oraret.*
*Shkollat fillore mund të jenë shtëterore, paritare, private.*



### Kur duhet bërë regjistrimi?

Cdo vit përcaktohet afati për regjistrimin në klasë të parë.
Përgjithësisht, regjistrimet kryhen në muajin janar për vitin shkollor që vjen.
Me mbërritjen në Itali, duhet bërë regjistrimi në shkollën fillore në cfarëdo periudhe të vitit.

### Cfarë dokumentash kërkohen për regjistrimin?

Dokumentat e kërkuara për frekuentimin e shkollës fillore janë:

- certifikata e vaksinimeve të detyrueshme;
- certifikata e lindjes;
- vdëftesën shkollore për fëmijët kanë frekuentuar shkollën në atdheun e tyre.

Shpeshherë shkollat nuk kërkojnë as certifikatën e vaksinimeve të detyrueshme, as certifikatën e lindjes pasi u drejtohen vetë zyrave që i lëshojnë ato.



### A është e mundur ngrënia në shkollë?

Po. Në shkollat fillore që punojnë me orar të plotë, paradite e pasdite, me drekën në kopësht, është e nevojshme të paguhet kuota për mensës që përcaktohet në bazë të të ardhurave të familjes.
Për këtë duhet pasur kodi fiskal dhe duhen paraqitur dokumenta mbi të ardhurat e familjes.
Në mensë mund të kërkohen menu të diferencuara për motive shëndeti (kërkohet deklarata e mjekut) dhe për motive fetare.





### Cfarë librash dhe materialesh përdoren në shkollë?

Cdo shkollë kërkon materiale të vecanta, si psh. Fletore, lapsa, ngjyra.
Është familja ajo që duhet të sigurojë materialet.
Në rast vështirësish të rënda ekonomike, mund t'i kërkohet ndihmë shkollës.
Tekstet shkollore janë falas dhe mund të tërhiqen pranë librarive duke paraqitur listën e autorizuar dhënë nga shkolla në fillim të vitit shkollor.
Dsa shkolla eksperimentale përdorin libra të vecantë, edhe këta falas.

## 8.4 Në cilën shkollë shkojnë fëmijët e moshës nga 11 në 13 vec?

*Prindërit mund të drejtohen në **Shkollën tetëvjecare më të afërt me banesën**.*
*Këtu mund të merren informacione mbi regjistrimin në shkollë dhe oraret.*
*Shkollat fillore mund të jenë shtëterore, paritare, private.*



### Kur duhet bërë regjistrimi?

Cdo vit përcaktohet afati për regjistrimin në klasën e parë.
Përgjithësisht, regjistrimet kryhen në muajin janar për vitin shkollor që vjen.
Me mbërritjen në Itali, duhet bërë regjistrimi në shkollën fillore në cfarëdo periudhe të vitit.

### Cfarë dokumentash kërkohen për regjistrimin?

Dokumentat e kërkuara për frekuentimin e shkollës fillore janë:

- certifikata e vaksinimeve të detyrueshme;
- certifikata e lindjes;
- dëftesën shkollore për fëmijët që kanë frekuentuar shkollën në atdheun e tyre.

Shpeshherë shkollat nuk kërkojnë as certifikatën e vaksinimeve të detyrueshme, as certifikatën e lindjes pasi u drejtohen vetë zyrave që i lshojnë ato.

### A është e mundur ngrënia në shkollë?

Po. Në shkollat tetëvjecare që punojnë me orar të plotë, paradite e pasdite, me



drekën në shkollë, është e nevojshme të paguhet kuota për mensës që përcaktohet në bazë të të ardhurave të familjes.
Për këtë duhet pasur kodi fiskal dhe duhen paraqitur dokumenta mbi të ardhurat e familjes.
Në mensë mund të kërkohen menu të diferencuara për motive shëndeti (kërkohet deklarata e mjekut) dhe për motive fetare.

### Cfarë librash dhe materialesh përdoren në shkollë?

Për frekuentim kërkohen librat për cdo lëndë që mësohet.
Shpenzimi maksimal që parashikohet për blejren e librave shkollorë për vitin e parë është rreth 250 euro.
Familjet e nxënësve me të ardhura familiare neto, më të ulët se 15,000 euro, mund të kërkojnë një kontribut individual për blerjen e librave duke iu drejtuar sekretarive të shkollave brenda muajit prill të vitit pararendës atij shkollor.



## 8.5 Në cilën shkollë shkojnë fëmijët nga 14 vjec e më tej?

*Në **Shkollën e Mesme** që përbëhet nga Lice, Institute Teknike e Profesionale, me lëndë e orare të ndryshme. Për frekuentimin e shkollës së mesme duhet dalluar tipi i shkollës së preferuar dhe duhet të drejtoheni direkt tek kjo shkollë për regjistrimin dhe të gjitha informacionet e tjera.*



### Për sa kohë vazhdon shkolla e mesme?

Shkolla e mesme zgjat 5 vjet dhe mbyllet me një provim shteti.

Në Institutet profesionale mund të frekuentohen kurse 3 vjecarë që mbyllen me një provim kualifikimi profesional, ose kurse 5 vjecare që mbyllen me provim shteti.

## 8.6 A ekzistojnë kontribute ekonomike për të lehtësuar shkollimin?

**Kontributi rajonal për zgjedhjen e lirë edukative** është një kontribut ekonomik që Rajoni Piemonte i jep familjeve rezidente (rezidencë anagrafike) në Piemonte,



(ose studentit në moshë madhore me bërthamë familiare autonome) që ndodhen në vështirësi të mëdha ekonomike, dhe për rrjedhojë shpenzimet shkollore ndikojnë negativisht mbi të ardhurat, për fëmijët që frekuentojnë shkollën fillore dhe tetëvjecare në shkollat shtetërore, jo shtetërore, paritare me qendër në Piemonte.

Kontributet e dhëna për një mbulim të pjesshëm të shpenzimeve lidhur me regjistrimin dhe frekuentimin gjatë vitit shkollor, shpenzime këto të dokumentuara nga familjet.
Këto kontribute nuk mbulojnë shpenzimet e bëra për udhëtime me qëllim mësimi, aktivitete integrative pregatitjeje dhe shpenzimet për librat shkollorë, shërbimin e mensës, trasporti dhe materiale mësimor.
Konsiderohen si shpenzime të pranueshme ato të bëra direkt nga familjet për personelin mësimor të impenjuar në aktivitete didaktike në mbështetje të nxënësve me handikap.
Kërkesës për kontributin i duhet bashkangjitur dëshmia e shpenzimeve të kryera nga nxënësi.

Kërkesa për kontributin rajonal për zgjedhjen e lirë edukative, duhet të paraqitet nga njëri prej prindërve, ose nga kush ushtron autoritetin (për persona që përfaqësojnë minorët nënkuptohen të gjithë ata persona juridikë a fizikë, të cilëve u është besuar minoreni, me urdhër të gjykatës së minorëve), ose nga studenti në moshë madhore me bërthamë familiare autonome, me shkrim, në formë autocertifikimi, sipas modelit të pregatitur nga Rajoni Piemonte.
Modularit i duhet bashkangjitur një dokument identiteti i vlefshëm.
Kërkuesi e plotëson kërkesën e tij me vërtetimin mbi të ardhurat komplensive të bërthamës së tij familiare përmes autocertifikim zëvendësues.



Dokumentat dhe modulari i kërkesës mund të gjenden:

në Buletinin Zyrtar të Rajonit Piemonte dhe në faqen e internetit të Rajonit Piemonte dhe Drejtorisë së Përgjithëshme Shkollore rajonale të Piemontes - MIUR (Ministria e Arsimit dhe Universitetit e Kërkimit):

www.regione.piemonte.it/istruz • www.piemonte.istruzione.it;

pranë institucioneve shkollore shtetërore e paritare;

pranë Komunës së rezidencës;

pranë Zyrave të marëdhënieve me me Publikun (U.R.P.) të Rajonit Piemonte[1].



## 8.7 Cfarë është detyrimi shkollor?

*Të rinjtë deri në vitin e 18 të jetës kanë për detyrim ndjekjen e* ***niveleve të shkollimit e formimit*** *që lejojnë marrjen e diplomës së shkoelës së mesme ose kualifikimi profesional.*

### Si mund të përjashtoheni nga detyrimi shollor?

Ata që kanë:

- mbushur 16 vjec,
- kanë frekuentuar shkollën për të paktën 9 vjet.

Mund të kompletojnë detyrimin shkollor në tre mënyra:

- brenda sistemit të arsimit shkollor, me marrjen e diplomës së shkollës së mesme;
- brenda sistemit të pregatitjes profesionale me marrjen e një kualifikimi profesional;
- punë si aprendist.

Kompetencat e vërtetuara të marra gjatë cfarëdo segmenti të pregatitjes shkollore, profesionale, si aprendist, përbëjnë kredi formative për kalimin nga një sistem në tjetrin.

### Ku mund të kërkohen informacione rreth detyrimit shkollor?

Në të gjitha Zyrat e Punës[2] është aktiv një sportel për detyrimin shkollor, në të cilin mund të gjenden informacionet mbi normatvën në fuqi e mbi aktivitetet e aprendistatit e pregatitjes profesionale.

### Cfarë dokumentash janë të nevojshëm për shërbimin e ofruar nga zyra e punës?

- Karta e identitetit;
- Kodi fiskal;
- Leja e qëndrimit për motive familiare, moshë të vogël ose kujdestari, për minorët e huaj që janë subjekt i detyrimit shkollor;
- Dokumente që konfermojnë përmbushjen e detyrimit shkollor (psh. Deftesa e shkollës së mesme).

1 - 2 Shih adresat në fund të udhëzuesit.



*Për informacione të mëtejshme lidhur me Kurset e Pregatitjes:*

**Ufficio della Regione Piemonte, Formazione professionale – Lavoro**
**Via Pisano, 6 • Via Magenta, 12 TORINO • Tel. 011 4321456 • 0114321549**

## 8.8 A munden të rriturit të frekuentojnë shkollën?

*Po, të huaj që duan të frekuentojnë shkollës mund të regjistrohen në Zyrat Territoriale Permanente (CTP)[3], që merren me shkollimin e qytetarëve të huaj. Funksionojnë në të gjitha qytetet e Rajonit Piemonte.*

### Cfarë mësohet nga C.T.P.?

Pasqyra e aktviteteve të realizuara nga Zyrat Territoriale Permanente është shumë e gjerë.
Propozohen përgjithësisht kurse për mësimin e gjuhës italiane, kjo në nivele të ndryshme, dhe kurse të ndryshme pregatitje profesionale.
Në të gjitha C.T.P. gjenden kurse për marjen e dëftesës së shkollës fillore dhe tetëvjecare, ashtu sikurse në pothuaj të gjitha zyrat, organizohen kurse kompjuteri, italishtja për të huaj, kurse gjuhësh të huaja, orientimi për punën përfshirë edhe stazhe në kompani, kurse për asistencën ndaj personave, etj.
Në shumë prej qendrave organizohen aktivitete kulturore (nga kinemaja në psikologji, aktivitete punë dore, etj...), dhe kurse për të rinjtë që duan të vazhdojnë studimet në Shkollën e mesme.
Kurset zhvillohen në mëngjes, pasdite dhe mbrëmje.

### Cila ëstë mosha më e ulët për t'u regjistruar në CTP?

15 vjec të mbushura.

[3] Shih adresat në fund të udhëzuesit.

## 8.9 Ku mund të gjenden informazionet për regjistrimin në universitet?

Pranë **Università degli Studi di Torino** *(Univesrsiteti të Torinos),*
**Sportello Studenti Stranieri** *(Sporteli për Studetët e huaj).*
Via S.Ottavio 17, 10124 Torino.
Tel. 011.6703961 • Fax 011.6703962 • E-mail: **stranieri@rettorato.unito.it**
Orari i hapjes:
nga e hëna në të premte 9.00 - 11.00;
të martën, të mërkurën, të enjten edhe në orarin 13.30 - 15.00.
Vizituar faqen e internetit:
**www.unito.it**
**www.unito.it/studenti/stud_stranieri/stud_stranieri.htm**

Pranë **Università degli Studi del Piemonte Orientale Amedeo Avogadro**,
*(Univesiteti i Piemontit Lindor Amedeo Avogadro)*
**Ufficio Ordinamenti Didattici** *(Zyra e Urdhërimeve Didaktike)*
Tel. 0161.261524 • Call Center 800 90 40 96

Pranë **Politecnico di Torino**, **Ufficio Mobilità Studenti** *(Zyra e Mobilitetit të Studentëve)*, pranë qëndrës kryesore të Politeknikut të Torinos
Corso Duca degli Abruzzi 24 (katin përdhes, në departamentin e Hidraulikës, Transporteve dhe infrastrukturave Cvile).
Tel. +39 011 5645930 • Fax +39 011 5646605 • E-mail: **incoming.students@polito.it**
Orari i hapjes i sportelit:
të hënë, të martë, të enjte e të eremte 9.00 - 11.30
Të mërkurën zyrat janë të mbyllura për publikun.
Duke vizitua faqën në internet:
**www.polito.it**









# 9 nënshtetësia italiane



### Cfarë nënkupton marrja e nënshtetësisë italiane?

Të gjitha të drejtat e detyrimet e parashikuara për qytetarët italianë.

### Si merret nënshtetësia italiane?

Nënshtetësia italiane mund të merret:

- Automatikisht,
- Përmes natyrizimit,
- Përmes martesës.

## 9.1 Kush merr automatikisht nënshtetësinë italiane?

*Nënshtetësia italia i takon **automatikisht**:*

- Fëmijës me baba ose nënë italiane.
  Pasardhësit e qytetarëve italianë të emigruar, që kanë marrë një tjetër nënshtetësi, mund të kërkojnë njohjen e nënshtetësisë italiane nesë tregojnë që asnjëri prej prejardhësve të tij nuk ka hequr dorë nga nënshtetësia italiane.
  Poseduesit e një leje qëndrimi të vlefshme (pavarësisht nga afati) mund të kërkojnë regjistrimin e tyre në regjistrin e amzës së Komunës e më pas mund të paraqesin pranë Punonjësit të Gjendjes Civile dokumentacionin për njohjen e nënshtetësisë.
  Më tej, mund të marrin **leje qëndrimi në pritje të nënshtetësisë.**
  Ndryshe, procedura mund të kryhet nga jashtë vendit përmes përfaqësisë konsullore.
- Fëmijës së lindur në Itali nga prindër të panjohur apo apolidë (dmth "pa atdhè").
- Fëmijës së lindur në Itali nga prindër të huaj, por vetëm në rastet kur ligji i vendit të prejardhjes së prindërve parashikon që fëmijët të mos ndjekin nënshtetësinë e prindërve (**nuk** merr nënshtetësinë kush ka lindur në Itali nga prindër të huaj që vijnë nga një Shtet që parashikon që fëmijët e lindur jashtë të marrin nënshtetësinë e prindërve, edhe pse mund të jenë bërë deklarata vullneti apo formalitete administrative).
- Fëmijës me prindër të panjohur, nëse nuk provohet nënshtetësia e tij.
- Fëmijëve minorenë që jetojnë me kë ka kërkuar apo merr nënshtetësinë italiane, me kusht që të heqin dorë nga nënshtetësia e parë kur të mbushin moshën madore.

- Minorenëve që njihen nga qytetarë italianë, ose për të cilët deklarohet birësimi nga qytetarë italianë, pas lindjes.
- Minorenë të birësuar nga qytetarë italianë.
- Të huajit lindur në Itali që ka ruajtur pa ndërprerje rezidencën deri në moshën 18 vjec, e që deklaron se zgjedh nënshtetësinë italiane përpara punonjësit të gjendjes civile të komunës së rezidencës, brenda një viti nga mbushja e moshës madore.
- Të huajit në moshë madhore që njihet apo deklarohet si bir i një qytetari italian, e që deklaron se zgjedh nënshtetësinë italiane përpara punonjësit të gjendjes civile të komunës së rezidencës, ose pranë përfaqësisë konsullore, nëse është me banim jashtë Italisë, brenda një viti nga birësimi apo deklarimi.



## 9.2 Si paraqitet kërkesa për njohjen e statusit si qytetar italian për shkak lindje?

**Autoriteti gjygjësor kompetent**.
Gjykata kompetente për vendin ku ndodhet autoriteti që ka lëshuar urdhëresën[1].

**Afati për paraqitjen të kërkesës**.
Asnjë.

Për asistencën ligjore nga Shteti (falas)



[1] Shih adresat në fund të udhëzuesit.

[2] Shih kapitullin 11 Tutela juridiksionale.



## 9.3 Kush merr nënshtetësinë italiane për shkak martese?

*Nënshtetësia italiane i takon për shkak **martese:***

bashkëshortit të një qytetari italian me kusht që:

- Martesa të jetë e vlefshme;
- Të banojë ligjërisht në Itali prej të paktën 6 muajsh, ose pas 3 vjetësh nga data e martesës (nëse ndërkohë martesa nuk është zgjidhur, anulluar apo ndërprerë në gjendje civile e në rast se nuk ka fillim praktikash për ndarje ligjore);
- Nëse nuk ka dënime penale në rastet e treguara me ligj, e në rast se po, nëse është rehabilituar plotësisht;
- Nëse nuk ka pengesa lidhur me sigurinë kombëtare.

**Nuk** kërkohet "zgjidhje", dorëheqja prej nënshtetësisë së parë.

Kërkesa paraqitet pranë prefekturës së Provincës së rezidencës[3].

## 9.4 Kush merr nënshtetësinë italine për natyrizim?

*Nënshtetësia italiane për **"natyrizim"** i takon:*



- Të huajve jo komunitarë rezidentë në Itali që prej 10 vjetësh;
- Të huajve jo komunitarë në moshë madhore fëmijë qytetarësh italianë e rezidentë në Itali që prej 7 vjetësh;
- Refugjatëve dhe apolidëve, rezidentë në Itali që prej 5 vjetësh;
- Të birësuarve nga qytetarë italianë, në moshë madhore, e rezidentë në Itali që prej 5 vjetësh;
- Qytetarëve të një shteti anëtar të Komunitetit Europian rezident në Itali që prej 4 vjetësh;
- Qytetarëve të huaj (komunitarë e jo) rezidentë në Itali që prej 3 vjetësh, dhe prindi ose njëri nga gjyshërit të ketë qenë qytetar italian.

Kërkesa duhet paraqitur pranë Prefekturës (Zyrës Territoriale të Qeverisë - U.T.G.) së Provincës së rezidencës[4].
Në rast dënimesh penale në Itali, këshillohet të merret rehabilitimi nga Gjykata e Sorveliancës[5] përpara se të nisen procedurat.

## 9.5 Si paraqitet praktika për të kundërshtuar refuzimin e kërkesës së nënshtetësisë për natyrizim?

(dhënie e nënshtetësisë italiane për shkak rezidence mbi 10 ose 5 vjet, për arsye martese me qytetar italian e në rastet e tjera të parashikuara nga ligji mbi nënshtetësinë).

**Autoriteti gjygjësor kompetent**.
Gjykata Administrative Rajonale (T.A.T.)competente për territorin ku ndodhet autoriteti që merr vendimin[6].

**Afati për paraqitjen e praktikës**.
60 ditë.

**Për asistencë ligjore me shpenzime në ngarkim të Shtetit (asistencë falas)[7]**.



3 - 4 - 5 - 6 Shih adresat në fund të udhëzuesit.

7 Shih kapitullin 11 Tutela juridiksionale.









# 10 refugjatët



## 10.1 Kush mund të kërkojë njohjen e statusit të refugjatit[1]?

*I huaji që ka frikën e perseguitimit në vendin e tij për arsye rrace, feje, kombësie, përkatësie sociale apo politike.*

### Kur paraqitet kërkesa për njohjen e statusit të refugjatit?

Kërkesa për njohjen e statusit të refugjatit u paraqitet forcave të policisë kufitare, ose, pas hyrjes në Itali, pranë cfarëdo Kuesture[2].
Në këtë rast, të huajit i lihet takim pranë Kuesturës për fotosinjalizimin dhe verbalizimin e praktikave.

### Cfarë dokumentash janë të rëndësishme për paraqitjen e kërkesës për strehim?

- Originali dhe një fotokopje të cfarëdo dokumenti në zotërim (teserë partie ose levizjeje politike, artikuj gazetash në origjinal, dokumenta identiteti etj.), që mund të shërbejnë për të treguar prejardhjen dhe arsyet e arratisjes;
- 4 fotografi format pashaporte;
- 1 pullë me vlerë 10,33 Euro.



Në mënyrë që policia të mund të pregatisi verbalin, kërkuesi i strehimit duhet t'u përgjigjet pyetjeve rreth udhëtimit, arsyes së arratisjes, familjen, adresën ku mund të kontaktohet, etj.

Kërkesa për njohjen e statusit së refugjatit mund të paraqitet edhe nëse nuk ka asnjë dokument personal.

### A ekziston mundësia e mbajtjes në qëndrat e pritjes pasi të jetë paraqitur kërkesa për strehim?

Personi që paraqet kërkesën për njohjen e statusit të refugjatit nuk mund të mbahet vetëm me qëllim hetimin e kërkesës së tij.
Megjithatë, kur të hyjnë në fuqi dispozitat e ligjit 189/02, kërkuesit mund të mbahen në "**qendrat e identifikimit**" në rast se:

- duhet verifikuar kombësia;
- duhen kontrolluar elementet në të cilët bazohet kërkesa;
- është e nevojshme të përcaktohet nëse Italia është shteti të cilit i takon të merret me cështjen.



Largimi pa arsye nga qendra mund të konsiderohet si tërheqje nga kërkesa për



njohjen e statusit të refugjatit.

Qendrat duhet të sigurojnë shërbimet e informimit dhe asistencës, qoftë edhe ligjore.

Ndalimi në qendra është i detyrueshëm në rastet kur personit që bën kërkesën i është komunikuar vendimi për largimin nga territori ose nëse është kapur në kushte parregullsie.
Në këto raste, kërkesa shqyrtohet brenda një kohe të shkurtër nga ana e Komisioneve të territorit për të drejtën për strehim.[3]
I huaji, duhet të merret në pyetje brenda 15 ditëve dhe vendimi merret brenda tre ditëve që vijojnë.

## Kur lëshohet leja e qëndrimit për kërkesë srehimi?

Pas bisedës, Kuestura, në rast se nuk ka një qendër identifikimi ku të mund të strehojë kërkuesin, i lëshon atij një **leje qëndrimi për kërkesë strehimi**.
Është një leje qëndrimi e përkohëshme, për tre muaj dhe e renovueshme deri në përfundimin e procedurave të njohjes.
Në pritje të lëshimit të lejes së qëndrimit, jepet një vërtetim me fotografinë e kërkuesit që i lejon atij qëndrimin e ligjshëm në Itali.

Në rast se nuk është caktuar ende vendi europian të cilit i takon komptenza për shqyrtimin e ceshtjes, të huajit i jepet një **leje qëndrimi "Konvencioni i Dublinit 15/6/90"**, me vlerë 1 mujore të rinovueshme.

## Cfarë të drejtash ka kërkuesi i strehimit?

- Të drejtën për t'u dëgjuar personalisht nga komisioni Qëndror për njohjen e statusit të refugjatit (pas hyrjes në fuqi të dispozicioneve të ligjit 189/02 dhe rregullores së aplikimit, Komisioni qëndror do të zëvendësohet nga një numër i caktuar Komisionesh territoriale, organizuar pranë prefekturave të caktuara nga qeveria)[4];
- Të drejtën për të caktuar gjuhën në të cilën dëshiron të flasë dhe një përkthyes;

10



[1] **Lënda që i përket njohjes së statusit të refugjatit është renovuar shumë nga ligji L.189 del 2002. Dispozitat e reja hyjnë në fuqi kur të miratohet rregullorja e aplikimit, që duhet ta bëjë më të qartë funksionimin e një procedure të re për njohjen.**

[2 - 3] Shih adresat në fund të udhëzuesit.

- Nëse minoren, të drejtën për asistencëne tutorit ose të personit të besuar edhe gjatë komunikimeve me komisionin;
- Në rast se nuk ka mundësi, të drejtën e një kontributi prej 17,56 euro që zgjat deri në 45 ditë për të dhe cdo anëtar të familjes së tij;
- Të drejtën e regjistrimit në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar, e për rrjedhojë të mjekut të bazës, kurat ambulatorike dhe të specializuara dhe shtrimit në spital;
- Të drejtën për banim në qëndrat e pritjes administruar nga Komunat, Prefekturat ose nga ente private (sipas mundësive);
- Të drejtën për qarkullim të lirë në territorin italian (por duke i komunikuar Prefekturës cdo ndryshim adrese);
- Të drejtën për t'u regjistruar në kurset e guhës italiane dhe për të ndjekur aktivitete të tjera që propozohen nga entet lokale dhe private;
- Minorëve u njihet e drejta për të frekuentuar shkollën (në Itali, prindërit kanë për detyrim të dërgojnë fëmijët në shkollë deri në moshën 16 vjecare).

Kush kërkon strehim **nuk** mund të punojë.

## Cfarë ndodh pas marrjes së statusit të refugjatit?



Pas marrjes së certifikatës së njohjes nga Komisioni, i huaji marr nga Kuestura e zonës ku banon[5] një **leje qëndrimi për "strehim" politik ose "leje strehimi**", e vlefshme për jo më pak se 2 vjet, dhe e renovueshme.

Nëse është i interesuar, refugjati mund t'i kërkojë Kuesturës kompetente[6] lëshimin e një dokumenti udhëtimi që i lejon atij të udhëtojë jashtë vendit duke ndjekur procedurat e vizave parashikuar për nënshtetësinë e refugjatit, dhe, brenda Komunitetit Europian pa vizë për jo më shumë se 3 muaj (përvecse në raste punë).

Leja e qëndrimit për strehim politik jep këto të drejta[7]:

- për punë në entet publike;
- për mbrojtjen juridiksionale;
- për mbrojtjen e të dhënave lidhur me kërkesë për strehim;
- regjistrimin në amzë;
- patentës së qarkullimit (nëse vjen nga vende që njihen nga Ministria e Transporteve);
- për martesë, ndarje, divorc;
- hyrjes në universitet me të njëjtin trajtim që i bëhet studentëve italiane;
- regjistrimin në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar;





- asistencës publike
- bashkimin familjar, pa pasur nevojë të tregojë nëse disponon të ardhura e banesë, sic u kërkohet qytetarëve të huaj;
- marrjen e nënshtetësisë italiane pas 5 vjetësh rezidence të legale.

### Cfarë ndosh në rast refuzimi të statusit të refugjatit?

I huaji të cilit nuk i njihet statusi i refugjatit  humbet lejen e qëndrimit dhe i kërkohet të lërë vendn brenda 15 ditësh.
Nëse qëndron në Itali mund të bëhet subjekt vendimi për largimin dhe riatdhsimin e tij.

Refuzimi mund të kundërshtohet pranë Gjykatës Civile ose në mënyrë të jashtë-zakonëshme, vetë Presidentit të Republikës, brenda 120 ditësh nga lajmërimi.

Paraqitja e kundërshtimit megjithatë nuk është e mjaftueshme për të evituar largimin.
Ligji i ri parashikon largimin e menjëhershëm për ata persona të cilëve u refuzohet statusi i refugjatit, me përjashtim të rasteve kur Prefektit i kërkohet autorizimi për të qëndruar në Itali në rast kundërshtimi ë vendimit.

Kush ka leje qëndrimi për kërkesë strehimi mund të kërkojë asistencën e një avokati me shpenzime të shtetit (asistencë falas) për të kundërshtuar refuzimin.[8]





[4 - 5 - 6] Shih adresat në fund të udhëzuesit.

[7] Për këtë këshillohet të lexoni kapitujt e caktuar të udhëzuesit.

[8] Për asistencën ligjore me shpenzime të shtetit shih kapitullin nr. 11 tutela juridiksionale.

## 10.2 Si paraqitet cështja kundër mospranimit të kërkesës për njohjen e statusit të refugjatit?

***Në sistemin e tanishëm në fuqi:***

**Autoriteti gjygjësor kompetent.**
Gjykata e zakonëshme[9].

**Afati për paraqitjen e cështjes.**
Asnjë.

**Shpenzime gjygjësore.**
Kontribut i unifikuar.

***Në vijim të hyrjes në fuqi të artikujve 31 e 32 të ligjit n. 189/2002:***

**Autoriteti gjygjësor kompetent.**
Gjykata e zakonëshme me përbërje monokratike[10].

**Afati për paraqitjen e cështjes.**
15 ditë nga njoftimi i vendimit të refuzimit të kërkesës për njohjen e statusit marrë nga komisionet territoriale(kur i paraqitet direkt gjykatës se zakonëshme me përbërje monokratike);
ose 5 ditë nga komunikimi i refuzimit së kërkesës për rishqyrtim (kur i paraqitet komisionit të rishqyrtimi së masës për mosnjohjen e statusit).

**Shpenzime gjygjësore.**
Kontribut i unifikuar.

**Për asistencë ligjore me shpenzime në ngarkim të Shtetit (asistencë falas)[11].**





## 10.3 Si paraqitet ankesa ndaj refuzimit të kërkesës për njohjen e strehimit politik, ose "kostitucional" ex art. 10 i Kushtetutës?

**Autoriteti gjygjësor kompetent.**
Gjykata e zakonëshme me përbërje kolegjiale[12].

**Afati për paraqitjen e cështjes.**
Asnjë.

**Shpenzime gjygjësore.**
Kontribut i unifikuar.

**Për asistencë ligjore me shpenzime në ngarkim të Shtetit (asistencë falas)[13].**

10

[9 - 10 - 12] Shih adresat në fund të udhëzuesit.

[11 - 13] Shih kapitullin nr. 11 tutela juridiksionale.










11
tutela
juridiksionale

## 11.1 Si garantohet asistenca ligjore (e një avokati)?

*Qytetarit pa të ardhura mund t'i sigurohet një asistencë ligjore e duhur nga instituti i **"ndihmesës me shpenzime të shtetit"**, prej të cilit, shpenzimet legale (dmth kostoja e avokatit e konsulentëve të tij) bien mbi shtetin italian.*

Në rast se njihet e drejta për asistencën falas, mbrojtësi dhe konsulenti teknik nuk mund të kërkojnë asnjë kompensim apo rimbursim prej të asistuarit, ndryshe nga ato të parashikuara nga ligji mbi asistencën falas (cdo marreveshje tjetër është e pavlerë dhe thyerja e rregullave përbën shkelje të rëndë profesionale).

Njohja e asistencës falas vlen për të gjtha shkallët e për cdo fazë të procesit e për cdo procedurë, të parashikuara ose jo.



### Cilat janë kërkesat për asistencën falas?

Mund t'i sigurohet asistenca falas personave që kanë një të ardhur personale vjetore jo më shumë se 9.296,22 Euro.

Nëse i interesuari bashkëjeton më bashkëshortin ose familjarë të tjerë, të ardhurat përbëhen nga shuma e të ardhurave të së njëjtës periudhë të cdonjërit prej pjestarëve të familjes, përfshirë atë që bën kërkesën për asistencën falas, por kufijtë e kësaj shume janë 1.032,91 për cdo familjar bashkëjetues.

Për përcaktimin e të ardhurave mbahet parasysh fakti që me ligj të ardhurat janë të përjashtuara nga taksat mbi të ardhurat për personat fizikë (IRPEF) ose që janë subjekte të taksave zëvendësuese.

Konsiderohet vetëm e ardhura personale në rastet kur janë objekt të të drejtave të personalitetit, dmth, në proceset ku interesat e kërkuesit janë në kundërshtim me ato të përbërësve të bërthamës familjare.

### Cfarë duhet të përmbajë kërkesa për asistencën falas?

Kërkesa, e shkruar në letër të thjeshtë dhe e firmosur nga i interesuari (firma mund të autentikohet nga mbrojtësi), duhet të përmbajë:

- kërkesën për miratimin e asistencës falas dhe cështjen së cilës i referohet, nëse ka filluar;
- të dhënat personale të të interesuarit dhe të anëtarëve të familjes anagrafike, bashkë me kodet fiskale respektive;





- një deklaratë zëvendësuese nga ana e të interesuarit, që tregon praninë e kushteve të parashikuara për asistencën, për përcaktim të saktë të të ardhurave komplensive;
- impenjimin për të komunikuar, për sa kohë që  procesi nuk është vendosur, variacionet e të ardhurave gjatë vitit paraardhës, brenda 30 ditësh nga mbarimi i afatit të paraqitjes së instancës ose të komunikimit të mëparshëm.

**Qytetari i huaj jo komunitar,** duhet të bashkangjisë një certifikatë që i referohet të ardhurave të mundëshme jashtë Italisë, certifikatë kjo lëshuar nga autoritetet konsullore kompetente që shënon vërtetësinë e të dhënave shkruar në kërkesë. Në rast se një dokument i tillë nuk mund të lëshohet, duhet zëvendësuar më një deklaratë zëvenësuese.



## Si rregullohet asistenca falas në një ceshtje penale?

Në një **cështje penale** instanca paraqitet ekskluzivisht nga i interesuari ose mbrojtësi, dmth, dërgohet si letër rekomande pranë zyrës së magjistratit që ka cështjen në shqyrtim.

Nëse vazhdon në Gjykatën e Kasacionit, instanca i paraqitet zyrës së magjistratit që ka marrë vendimin që kundërshtohet.

Instanca mund të paraqitet nga mbrojtësi gjatë udiencës.

Nëse i interesuari është në burg apo në ndonjë institut, kërkesa paraqitet me një akt marrë nga drejtori i institutit.

Nëse është në gjendje arresti apo arrest shtëpie, duhet t'ia paraqesë policisë gjygjësore. Në këtë rast, certifikata e autoriteteve konsullore (që i kërkohet qytetarëve jo komunitarë) mund të lëshohet brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së instancës, nga mbrojtësi ose nga ndonjë anëtar i familjes së të interesuarit.

Për deklarata zëvendësuese të rreme ose mbulime të dhënash ndëshkohen me burgim nag 1 deri në 5 vjet ose me gjobë që shkon nga 309,87 Euro në 1.549,37 Euro.
Ndëshkimi shtohet nëse prej këtyre dokumentave është marrë asistenca falas.
Dënimi sjell revokimin, edhe retroaktiv, dhe rekuperimin e shumave të paguara nga shteti.

Efektet e asistencës falas bien në momentin që personi të cilit i është akredituar ndihma, emëron një tjetër avokat të besuar.



## Si rregullohet asistenca falas në një ceshtje penale për minorët?

Në një proces penal për minorë, asistenca falas sigurohet nga ligji për minorët e asistuar nga avokatë shtetërorë, ose nga në avokat i caktuar nga magjistrati (Pubblico Ministero – P.M. – ose Gjykatës).
Familjarët e minorit nuk duhet të paraqesin kërkesë për asistencë falas duke qënë se avokati që caktohet për mbrojtjen paguhet nga shteti.
Familjarve u kërkohet vetëm të dokumentojnë kushtet e të ardhurave.
Në rast se vërtetohet së të ardhurat janë më të larta se ato si kusht për dhëninen e asistencës falas, shteti ka të drejtë të kërkojë cfarë i ka paguar mbrojtësit. Nëse familjarët vendosin të emërojnë një mbrojtës të besuar, atëherë duhet të paraqesin kërkesën për asistencën falas sipas formave të caktuara për procesin penal.

## Si rregullohet asistenca falas në një ceshtje kundër masës së largimit?

Në rast ankese ndaj masës së largimit, të huajit i jepet e drejta për asistencën ligjore nga ana e një avokati të besuar, që ka prokurën e lëshuar para autoriteteve konsullore në rast se largimi është kryer.

Nëse nuk ka një avokat, atëherë asistohet nga nja avokat i caktuar nga gjykatësi marrë nga listat e avokatëve të disponushëm për marrjen në mbrojtje në proceset penale.



**Në këtë lloj procesi, i huaji përfiton me ligj automatikisht asistencën falas.**
Nuk duhet të paraqesë asnjë kërkesë apo lëshojë deklarata mbi të ardhurat.
Me depozitimin e ankesës kundër dekretit të largimit, i huaji përfiton automatikisht nga asistenca falas dhe avokati i tij (i besuar apo i caktuar) paguhet nga shteti, dhe natyrisht, nuk mund të kërkojë pagesë prej të asistuarit të tij.

## Si rregullohet asistenca falas në një cështje civile, administrative e komunitare?

Në një proces civil, administrativ, kontabël e tributar mund të bëjë kërkesë për asistencë falas:

- I huaji me qëndrim të rregullt në territorin italian në momentin kur lind problemi objekt i procesit;
- apolidët;
- entet dhe shoqatat që nuk kanë qëllim fitimi dhe nuk kryejnë aktivitet tregtar.





Instanca e akordimit të asistencës falas duhet të përbajë informazionet e duhura për të vlerësuar mos manifstimin e pa bazëshmërisë së pretendimeve të ngritura.

Instanca paraqitet vetëm nga i interesuari apo avokati i tij, dmth, dërgohet si rekomande Këshillit të urdhërit të avokatëve.[1].

Këshilli i urdhërit kompetent është ai i vendit ku ndodhet magjistrati që shqyrton cështjen, dmth, nëse cështja nuk është ende në shqyrtim, atëherë është ai i vendit ku ndodhet magjistrati kompetent për argumentin që trajtohet.

Nëse ceshtja shkon në Gjykatën e Kasacionit, Këshilli i shtetit, dmth seksionet e mbledhura ose seksione jurdiksionale qëndrore panë Gjykatës së Lartë, këshilli i urdhërit kompetent është ai i vendit ku është magjistrati që ka lëshuar vendimin e kontestuar.

Sanksionet në rast deklaratash të rreme janë të njëjta me ato që parashikohen për proceset penale.

Gjatë 10 ditëve pas paraqitjes ose ardhjes së instancës së pranimit, Keshilli i urdhërit të avokatëve, pasi të ketë verifikuar pranueshmërinë e instancës, i akordon të interesuarit, në mënyrë të përshpejtuar e provizore, asistëncën falas, nëse, në bazë të deklaratës zëvendësuese, janë të pranishme kushtet mbi të ardhurat, të cilave u nënshtrohet akreditimi, dhe nëse pretendimet e të interesuatit nuk shfaqen si të pabazuara.

Kopia e aktit me të cilin Këshilli i urdhërit pranon ose refuzon, dmth, deklaron si të papranueshme instancën, i transmetohet të interesuarit dhe magjistratit.

Nëse Këshilli i urdhërit refuzon ose deklaron si të papranueshme instancën, kjo mund t'i propozohet magjistratit kompetent për gjykim, që vendos me dekret.





[1] Shih adresat në fund të udhëzuesit.

## 11.2 Cfarë nënkuptohet me "barazi në trajtim"?

*Me "**barazi në trajtim**" nënkuptohet mungesa e cfarëdo lloj diskriminimi.*

### Cfarë nënkuptohet me diskriminim?



Përben **diskriminim** cdo sjellje që

Direkt ose jo direkt[2], con në një dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë bazuar në: rracën, ngjyrën, prejardhjen ose originën kombëtare o etnike, bindjet dhe praktikat fetare, dhe që ka për qëllim ose pasojë shkatërrimin apo komprometimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive kryesore, në fushën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore dhe në cdo sektor tjetër të jetës publike.

Kryen një akt diskriminimi:

- zyrtari apo personi i ngarkuar për kryerjen e një shërbimi publik ose personi që kryen një shërbim publik, që gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kryen apo fsheh veprime në lidhje e një qytetar të huaj, që vetëm pse është i huaj apo i përket një rrace, feje, etnie apo kombësie të caktuar, diskriminohet padrejtësisht;

2 Verifikohet një **diskriminim direkt** kur, opër rracë ose origjinë etnie, një person është trajtuar me keq sc është, do të, apo ka qenë trajtuar në situata analoge.
Verifikohet një **diskriminim jo direkt** kur një dispozitë, një kriter, një praktikë, një akt, një marrevëshje a sjellje në pamje neutrale, mund të vënë personat e një rrace apo origine etnie të caktuar në një pozitë inferiore në krhasim me persona të tjerë.





- Kushdo që imponon kushte më të vështira apo refuzon kryerjen e një shërbimi publik një të huaji, vetëm për shkak se është i huaj apo i përket një rrace, feje, etnie apo kombësie të caktuar;
- Kushdo që imponon kushte më të vështira apo refuzon  punësimin, banesën, shkollimin, pregatitjen dhe shërbimet shoqërore e socio-asistenziale, të huajit me qëndrim të rregullt në Itali, vetëm pse është i huaj apo i përket një rrace, feje, etnie apo kombësie të caktuar;
- Kushdo që pengon ushtrimin e një aktiviteti ekonomik të ligjshëm të një të huaji me qëndrim të rregullt në Itali, vetëm pse është i huaj apo i përket një rrace, feje, etnie apo kombësie të;
- Punëdhënësi ose përfaqësuesit e tij, të cilët kryejnë veprime apo sillen në mënyrë të tillë saqë provokojnë një pasojë paragjykuese e diskriminuese, qoftë edhe jo në mënyrë direkte[3], ndaj punëtorëve në bazë të përkatësisë në një rracë, etni apo gjuhë, fe, nënshtetësi.

Konsiderohen diskriminacione edhe ngacmimet apo ato sjellje të padëshëruara, me qëllime kërcënue shtyrë nga rraca, etnia, për dhunimin e dinjitetit të një personi e për të krijuar një atmosferë fyese fhe ofensive.

Konsiderohet diskriminim edhe urdhëri për të diskriminuar personat për shkak të rracës apo origjinës së tyre etnike.



**Nuk** përbëjnë akte diskriminimi:

- Dispozitat komëntare për hyrjen, qëndrimin, punësimin, asistencën dhe previdencën e qytetarëve që vijnë nga vende të tjera dhe të apolidëve në territorin shtetëror;
- Ndryshimet në trajtimin përsa i përket marrdhënieve të punës apo ushtrimit të një aktiviteti sipërmarrës, në rastet kur karakteristikat e lidhura me rracën apo origjinën etnike  të personit përbëjnë një kërkesë të rëndësishme dhe determinuese për përmbushjen e aktiviteteve të sipërpërmendura.

[3] Përbën diskriminim jo direkt cdo trajtim paragjykues si pasojë e përdorimit të kritereve që pengojnë së tepërmi punonjësit që i përkasin një rrace, etni apo gjuhe, feje a nënshtetësie e që kanë të bëjnë me kërkesat jo thelbësore për kryerjen e punës.





## 11.3 Si tutelohet në nivel juridiksional parimi i barazisë së trajtimit?

*Mund t'i apeloheni* ***Aksionit Civil kundër diskriminimit*** *nëse parimi i barazisë në trajtim është shkelur si më poshtë:*

- Punësim, i pavarur apo me kontratë, përfshi edhe kriteret e seleksionimit dhe kushtet e punësimit;
- Punësim dhe kushtet e punës, përfshi ecjen në karrierë, pagesën dhe kushtet e pushimit;
- Aksesin në të gjitha nivelet e orientimit dhe pregatitjes profesionale, perfeksionimit dhe rikualifikimit profesional, përfshi praktikat profesionale;
- Aktivitete me organizatat e punëtorëve, punëdhënësve apo organizata të tjera profesionale dhe shërbime kryer ndaj këtyre organizatave;
- Mbrotja sociale, pëfshi edhe sigurinë;
- Shërbimin shëndetësor;
- Shërbime sociale;
- Shkollim;
- Aksesin në shërbime, përfshi banesën.

### Si paraqitet kërkesa për aksion civil kundër diskriminimit?

Kërkesa paraqitet e depozituar, edhe personalisht, në kancelarinë e gjykatës me përbërje monokratike të vendit ku banon kërkuesi[4].

Gjykata me përbërje monokratike urdhëron pranimin apo refuzimin e kërkesës.

### Kush është i ligjëruar të veprojë kundër akteve të diskriminimit?

Kjo mund të kryhet nga:

- Subjekti që ka pësuar diskriminimin;
- Shoqatat dhe entet që veprojnë në favor të imigrantëve; që zhvillojnë aktivitete në fushën e luftës kundër diskriminimit dhe të promovimit të barazisë në trajtim, të regjistruara në regjistrat përkatës.
  Në këtë rast, është e nevojshme që personi viktimë e diskriminimit të delegojë këto shoqata e ente, për veprime publike ose t'u lëshojë një autorizim të autentikuar.
  Shoqatat dhe entet e sipërpërmendura janë të legjitimuara të veprojnë në rast diskriminimi kolektiv, nëse personat e dëmtuara nga ky veprim nuk janë personalisht të identifikueshme.

## Cfarë mund të vendosë gjykatësi në rast pranimi të kërkesës?

Me urdhërin që pranon kërkesën, gjykatësi mund të:

- urdhërojë dëmshpërblimin qoftë edhe jo patrimonial;
- urdhërojë ndalimin e sjelljes apo veprimit diskriminues, nëse vazhdon akoma;
- urdhërojë pezullimin e efekteve të veprimit diskriminues;
- mund të urdhërojë publikimin e sentencës me të cilën vërteton diskriminimin, me shpenzime të atij që ka kryer veprimin, për një herë të vetme, në një gazetë ditore me shpërndarje në gjithë territorin.

[4] Shih adresat në fund të udhëzuesit.











Finito di stampare nel mese di gennaio 2004
da Ages Arti Grafiche, Torino